

M. ZALOSHNA

Iëndohet  
një plagë  
e vjetër

8/11-22  
Z 22

MOISI ZALOSHNA

LËNDOHET  
NJË PLAGË E VIJETËR

BIBLIOTEKA E SHTËPIËS  
DITËS SË SOTËS  
3000296  
(PREGIMË)

3441

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FASHËRI»

## M A N T U A

Kish pesë vjet që punonte pastruese në prefekturë. Godina e madhe e prefekturës kishte njëzet dhoma, dy sallone të mëdhej, gjithë ato dritare, dhe asaj i duhej t'i fshinte ditëpërditë e t'i lante dy herë në javë; kurse dyshemetë e disa zyrave që ishin të shtruara me parket, si ato ku rrinte zoti prefekt, drejtori i financës, kryesekretari i prefekturës e të tjera, duhej edhe t'i dylloste herëpashere.

Në këtë vënd e kishte rregulluar kryesekretari i prefekturës.

Ditën e parë që do të fillonte nga puna, kryesekretari e thirri në zyrën e tij, i tregoi se ç'do të bënte, e këshilloi si do të sillej me zyrtarët, e porositi të tregohej shumë e kujdesëshme për pastrimin dhe, përpara se të ikte, i tha:

— Dëgjo, ti, Shega: si të kesh mbaruar punët këtu, del edhe një herë andej nga shtëpia, ndihmoje atë gruan time për ndonjë rrobe a për ndonjë enë që mund të ketë për të larë, se nuk të lë pa ta shpërbyer.

Shega e falënderoi për këtë të mirë të madhe që i bëri dhe doli. Që nga kjo kohë, ajo punonte edhe si pastruese në prefekturë edhe si

shërbëtore e kryesekretarit, kështuqë i takonte të punonte që në agim e gjer natën vonë.

Ishte fundi i nëndorit. Ajo mbaroi punët në prefekturë dhe që andej iku shpejt e shpejt te zonja e kryesekretarit, e cila nuk kishte ditë të mos e porositëte: «Dëgjo, nesër eja njëçikë më shpejt, se sot prapë erdhe vonë». Dhe ajo, me atë trishtimin e heshtur në fytyrë, që i ishte bë-rë natyrë e dytë, i përgjigjej: «Mirë, zonjë. Po atje ka shumë punë».

Në shtëpinë e zonjës e prisnin një pirg me enë të palara dhe një tog me rroba të fëmijëve. Dy orë pasi qe errur, i kreua të gjitha punët, vajti edhe në furrë mori bukën dhe një byrek ja pruri zonjës dhe e pyeti:

— Të shkoj unë tanë, zonja Irini?

— Mirë, shko, — i tha ajo si i hodhi një sy guzhinës për të parë mos kishte mbetur gjë mangut.

Me supat mbledhur dhe me duart futur në gji, ndënë xhaketën e vjetër e të hollë, Shega mori rrugën për të vajtur në shtëpinë e saj, ku e prisnin katër fëmijë, më i madhi njëmbëdhjetë vjeç e më i vogli katër vjeç, dhe vjerri e vjerra, dy pleq që kishin zenë këndet e që nuk ishin të zotët për asgjë veçse për të ngrënë. Shtëpia e saj nga ajo e kryesekretarit mbante gjysëm ore. Kishte rënë dy pëllëmbë dëborë. Thëlli-mi të thante. Sa tërë punët e ditës i rëndej kjo rrugë e gjatë, e veçanërisht në dimër, të cilën i duhej ta bënte ditëpërditë në këtë orë të natës, e nganjëherë edhe më vonë; sepse kishte raste që, kur i kërkonte lejë zonjës, kjo i përgjigjej: «Jo, jo, vër edhe djalin njëçikë në gjumë e pastaj ikë».

Kur qe martuar, Shegës i pati bërë i shoqi, midis atyre pak plaçkave të tjera, edhe një manto. Me atë kaloi shumë dimëra, gjersa iu bë zhele. Pastaj bleu një tjetër të përdorur, me të cilën kaloi edhe disa dimëra të tjerë. Tani ishte i treti dimër që po e kalonte pa manto. Ky ishte shkaku që i rëndej edhe më shumë kjo rrugë e gjatë. E vjerra e qërtonte gjithmonë:

— Po bli një gjë të trashë për dimër e vishe, moj nuse, se do të marrësh ndonjë plevit! Ti e sheh që ne vetëm nga duart e tua presim!

Mirëpo me se ta blinte? Me ato dy napolona që merrte rrrogë në muaj? Ishin tetë gojë. Qiraja e shtëpisë duhej larë, drita duhej paguar, fëmijët i kishte lakuriq! I shoqi, më parë, i sillte ndonjë lekë shtëpisë rrallë herë, po këta dy vjetët e fundit nuk gjente punë as për bukën e gojës. Ja, ai kishte gjashtë muaj që qe larguar nga shtëpia fare dhe gjatë kësaj kohe vetëm një napolon i kishte dërguar. Në letrat e tij të shpeshta i shkruante: «Jam shëndoshë e mirë. Para nuk kam t'ju dërgoj. . .».

Po të kishe një dritë e t'ja hidhje në fytyrë këtë natë të ftohët duke u kthyer në shtëpi, në sytë e saj do të vije re menjëherë urrejtjen e egër ndaj jetës, që i ishte grumbulluar në shpirt e që nuk mundëte ta fshihte, se vetë sytë e saj e tradhëtonin. Duke ecur rrugës mendoi për një manto të vjetër të zonjës Irini, që i kishte thënë ta blinte. Si të bënte? Të nesërmen ishte dita e marrjes së rrrogës. Zonja Irini e kishte ulur çmin min e mantos gjer në një napolon. Më pak nuk mund t'ja jepte, këtë e kishte të qartë. Vërtet mantua nuk ishte e keqe e mund t'i kalonte me të pesë dimëre, në mos më shumë, se ajo që si e

pa mbajtur fare dhe zonja e shiste nga që i kishte ikur moda, por edhe një napolon nuk ishte pak pér atë. Me dy napolonat që do tē merrte ajo tē nesërmen, do tē lante tridhjetë lekët që kishte borxhe, ku pesë e ku dhjetë në-pér zyrtarët e gjetiu. Po tē blinte manton, si do ta ngryste muajin me shtatëdhjetë lekë?! Kryesekretari i kishte thënë: «Shko ndihmoje edhe atë gruan time, pa nuk tē lëmë pa ta shpérblyer». Po puna që kryente tek ai ishte sa pér një shërbyses, e jo ndihmë. Ata i kishin dhënë herë pas here ndonjë rreckë tē fëmijëve, ndonjë shpérblim tē vogël më ndonjë festë bajrami e pashke; po vetëm kaqë? Ishin pesë vjetë këta që po shtinte brinjët në shtëpinë e tyre: «Ah, sikur t'i bënte goja asaj zonjës Irini e t'i thoshte: «Na, merre këtë manto, moj Shegë, ta kam falur, se u thave edhe ti së ftohti». Çdo darkë, kur largohej nga shtëpia e kryesekretarit dhe zonja i zinte ngojësh punën e mantos, asaj i dukej sikur do t'ja thoshte këto fjalë, prandaj i mbante këmbët në koridor dhe pyeste: «The gjë, zonjë?» dhe ajo i përgjigjet: «Jo, jo, tē thashë ta marrësh, se më vjen keq, do sëmuresh», e pastaj vazhdonte si zakonisht: «U, dale se harrova, bëre mirë që nuk ike, shiko nesër eja pak më herët».

Kur vajti në shtëpi, dy pleqtë i gjeti si gjithmonë ulur në këndet dhe fëmijët rrëth vatrés duke u ngrohur. Ata i hapën vënd dhe ajo u ul duke kërcitur dhëmbët nga tē ftohit. Si i ngrohu, duart zunë t'i dhimbnin, se i ra për-thuash. «Vdiqe moj korbë!» mendoi e vjerra; dhe fëmijët, me shpirt tē përcëlluar që në atë moshë tē njomë, e vështronin pa bërë zë. Si u ngroh, shtruan tē hanin darkën. Duke u përtys-

pur nëna vështronte fëmijët me dhimbsuri e fëmijët vështronin nënën si me frikë, sikur ajo do t'u çfrynte se për ata po dergjej në punë e në të ftohët.

— Nesër nëna merr rrrogën, — u tha Shega me zë përkëdhelës e tërë ngrohtësi, — do t'u bie mish, fasule, djathë, gështenja, plot gjëra të mira.

Gëzimi që u derdhi ajo në zemër ua çeli ftyrat të vegjëlve dhe vunë buzët më gaz gjithë dëlirësi, duke vështruar njeri tjetrin në sy.

— Bli edhe ti mami një manto, — i tha Vera.

— Do të ble, të keqen mami, do të ble, — iu përgjegj eëma duke i përgëzuar flokët.

Fytyra e vajzës i pruri ndër mënd Shegës vitet e fëminisë e të rinisë së saj, që tanimë ja kishin rrëmbyer vojtjet, mundimet, jeta e ash-për që e kishte kërrusur pa mbushur tridhjetë vjeçët dhe që ja kishte bërë shpatullat si t'ishin peshorja e jetës. Në këtë çast ajo kujtoi me zëmër të lënduar edhe fjalët e drejtorit të financës, që i kishte thënë: «Ti Shega na shtire datën, kështu e kruspullo sur siç rri! Këtu i thonë prefekturë, vjen çdo njeri, është turp edhe për ne kur të shohin ty kështu...» Ai nuk e kishte mbaruar fjalën, po domosdo me mëndjen e tij do të ketë thënë: «kështu si mace e ngordhur!». Sa frikë e kishte këtë njeri, se ishte i egër, i pa afruar, sqimatar; të gjithë të tjerët i vështronte si nga lart e me përcëmim! Ai s'dinte q'është mëshira. Po sikur t'i thoshte zotit prefekt: «Pushoje këtë pastruese, se na turpëroi»? Prefekti do ta pushonte menjëherë; ata të dy ishin. . . me njeri jatrin. Prandaj, duke ngrënë, Shega mori vendim me vete: «Do ta marr atë të shkretë man-

to. Kam edhe atë fustanin e ri, do ta vesh edhe atë. Pa kushedi, i ka shkuar mbarë burrit andej nga është, na dërgon ndonjë lekë edhe ai, dhe nuk vuajmë. . ».

Të nesërmen shkoi në punë. Në darkë, kur do të kthehej në shtëpinë e saj, ja hapi fjalën e mantos zonjës Irini:

— Si thua, zonjë, do të ma japësh atë manton?

— Unë të kam thënë, merre, mos e lerë, se e ke të falur për aqë para, — iu përgjegj zonja pa i ngritur sytë nga qindimi që kishte në dorë.

Ajo deshi t'i lutej t'ja jephte me të pritur, në mos për të gjithë, për gjysmat e lekëve. Mirëpo e dinte mirë që nuk do t'ja bënte këtë nder. Qëndroi një copë herë më këmbë në mes të guzhinës e menduar. Para syve i dolli drejtori i financës me ato mustaqet e žezat të rrojtura spic tek e vështronë me bishtin e syrit e si t'i vinte të pështirë prej saj. Psherëtiu thellë dhe tha:

— E po mirë, zonjë, nema.

Pastaj u kthyte si mënjanë, nxori një napolon nga gjiri e ja zgjati zonjës. Napoloni dridhej në dorën e saj si gjethja e pemës nga një erë e lehtë.

Ajo nuk e veshi manton që brënda, se i erdhë turp nga zonja e ca më shumë nga zoti kryesekretar. Iu uroi natën e mirë e u nis të shkonte. N'atë kohë burr' e grua u shikuan sy në sy dhe Irini e ndaloi:

— Shega, prit pak, prit.

Mori napolonin mbi tryezën e bukës, e futi në sirtarin e bufesë dhe nxori që andej dhjetë lekë.

— Merri këto, — i tha, — pér nëndëdhjetë lekë po ta japim.

Shega do të dëshironte të derdhte një lumë urimesh në atë çast, se iu duk sikur ja falën manton kur ja ulën edhe dhjetë lekë, por nuk tha gjë tjetër veçse një falënderim dhe iku.

Me të dalë në rrugë, e veshi manton dhe shpejtoi këmbët. Dëbora e ngrirë kërciste si pas ritmit të hapave të saj. Ajo i ndjeu brinjët të ngrohta e një kënaqësi e ëmbël i mbushi zëmrën.

Përpara ishte dyqani i Xha Tolit, i cili shishte pemë e zarzavate. U kthye atje dhe e mbushi zimbilin me të gjitha të mirat. Xha Toli, sa herë që i zbraste gjërat në zimbil, i hidhte nga një sy mantos që kishte veshur. «Kushedi si do të kujtojë ky qyq!» mendoi me vete Shega. Po le të mendonte si të donte xha Toli. Ajo kishte ikur nga shtëpia e zonjës dhe nga prefektura duke marrë gjithmonë me vete ndërgjegjen e qetë dhe shpatullat e dërrmuara.

Atë darkë qe festë në shtëpinë e Shegës.

Vera ja kishte parë veshur atë manto zonjës Irini dhe kishte dëshiruar ta prekte me dorë si e vogël që qe. Sa hije i kishte zonjës ajo manto! Po ja edhe nënës së saj i rrinte shumë mirë. Sikur të ishte nëna e saj ashtu e ngjallur me ato duar topolake e të bardha qumësht si Irini, do t'i rrinte edhe më hijshëm se zonjës. Në mëngjez, kur veshi edhe fustanin e ri, Vera e vështroi t'ëmën me sy plot adhurim, i pushtoi gjunjët dhe thirri vetveti:

— Sa të bukur të kemi, moj mami!

Me sy plot përhirim e vështronin të gjithë fëmijët nënën atë mëngjez, i gjemonin në mënyrë të veçantë dhe ndjenin një nderim të veçantë pér të. Kështu si me fëmijët i ndodhi edhe me

zyrtarët. Ata dukej sikur e nderonin më shumë, e urdhëronin ose e thërrisin me një zë tjetër; kur bisedonin me të, disa përdornin fjalë e shprehje që përdornin edhe midis tyre: «Eja pak, të lutem», «Merre këtë, të lutem», «Ma pastro edhe mua pak trapezën, po qe e mundur». Edhe drejtorit të financës mundet që nuk i dukej më si «mace e ngordhur», se nuk i pat hedhur më ndonjë fjalë që ta fyente ai gojëvrazhdët.

Shega nuk i shleu huatë që kishte marrë. Ajo i ktheu vetëm magazinierit të botores pesë lekët, sepse ai ishte nevojtar. Të tjerëve u tha se do t'ua paguante kur të merrte rrogën e muajit në vazhdim. Mirëpo muajin tjetër të gjithë në-punësve të vegjël dhe shërbëtorëve, nuk u dhanë rrogë, se nuk kishte arka e financës të paguante. Shega i shkrojti letër të shoqit, i tha përmantton që kishte blerë dhe i kërkoi para. Ai iu përgjegj se nuk kishte dhe se përmjet një muaj a një muaj e gjysëm mund të kthehet pa punë në shtëpi. Ç'të bënte? Të kërkonte hua? Mirëpo, atyre që i huanin gjithmonë, ajo nuk u kishte shlyer akoma ato të parat. Po t'u kërkonte të tjerëve, kot sa të nxinte faqen. I kaloi edhe dy-tri ditë me borxh nëpër fqinjët dhe mbeti përsëri. Bakkalli i dha me të pritur gjer një dollar, aqë sa ja kishte caktuar, e pastaj ja ndaloi. Furrxhiu po ashtu. Më në fund filloi të kërkonte ndër zyrtarët. Shumica e përcillnin pa i dhënë gjë. Ndonjëri mezi vinte dorën në xhep e i thoshte: «Sa don ti nuk kam, po na këto pesë lekë e bëj si të bësh, se edhe unë jam keq përvete».

Kaloi një muaj pa rrogë dhe erdhi fundi i të dytit. Shega shkonte gjithnjë me shpresën e dy rrogave e mendonte se do të shpëtonte. Vér-

tet më shumë se gjysmën e atyre të hollave që do të merrte i kishte ngrënë hua, po të paktën do t'i mbeteshin sa të mbante fëmijët me frymë. Me të ardhur fundi i muajit të dytë, nëpunësit u derdhë nga arka e financës, por arkëtari i përcolli me dy fjalë: «S'ka para. Mos shpresoni pér rrogat». Dhe kur e pyesnin se kur do t'i paguanin, ai ngrinte supat. Shegës i ra pika. Një shpresë të vetme kishte tanë: Po bëheshin pesë vjet që i shërbente zonjës Irini, por pesë lekë hua nuk i pati kërkuar kurrë ndonjë herë. Ajo duhej t'i jepte.

— Zonjë, — i tha në darkë, para se të ikte, — unë i kam fëmijë pa bukë sot. . . — Dhe priti më këmbë me zemër të dredhur.

Zonja vështroi nga i shoqi dhe pa u menduar fare iu përgjegj:

— Nuk kemi. Burri nuk ma pruri rrogën, ti e di. Edhe pér vete nuk e dimë si do bëjmë.

Valë helmi e dëshpërimi si atë çast nuk kishin vërvshuar ndonjë herë në shpirtin e saj, sa do ngushtë që pati rënë. Kot tha zonja: «edhe pér vete nuk e dimë si do bëjmë», sepse gjelin e pjejkur ajo ja kishte prurë vetë nga furra atë darkë, dhe ajo e dinte shumë mirë se pér prefektin, pér kryesekretarin, pér drejtorin e financës e pér ndonjë tjetër kishte tjetër bordero. Mbylli derën ngadalë e sapo kaloi pragun e derës iu bënë fëmijët rrëth vatrës tek e prisnin. «Si të bëj?» tha dhe vështroi nga qielli. Po megjithse qielli qe i kthjellët nuk pa as yje as gjë veç errësirës. Vajti në furrrë e iu lut furrxhiut. Ai i dha një bukë tërë hundë e buzë dhe ja preu shkurt: «Mos më kërko tjetër herë se nuk të jap më. Edhe sot. . . veç s'kam ç'bëj!»

Tërë atë natë mendoi si do të bënte, po asgjë nuk kishte të shiste veç mantos. Vëtëm ajo mund të shkonte në pazarin e vjetërsirave. U ngrit në mëngjez sa ra dita, u vesh dhe shkoi në pazar. Një pjesë e dyqaneve qenë çelur, por kishte edhe të tjerë që nuk ishin hapur akoma. Tek shihte mantot e varura nëpër dyqanet e hapur, ose ato që i varnin radhë e radhë ata që çelnin më vonë, i vinte maras. «Shiko sa manto ka për të shitur!» thoshte me vete. «Pastaj shiko, vërtet të vjetra janë, po janë të lara, të hekurosura si në kallëp, sikur të jenë të reja; t'i marrin sytë; kurse kjo imja. . .» dhe hidhte sytë e e vështronte. Ajo do të dëshéronte të mos kishte manto fare në pazar dhe të gjithë nevojtarët t'i derdheshin mantos së saj. Por veç këtyre që shihte me sy kushedi edhe sa shitës vjetërsirash të tjerë do të vinin gjer nga ora nëndë-dhjetë! Kushedi edhe sa nevojtarë të tjerë si ajo do të mbushnin pazarin edhe për pak, sa të mos kishe vënd nga të vërtiteshe, dhe ajo do të humbiste në mes të gjithë asaj turme. Shkoi në disa nga tregëtarët që blinin vjetërsira dhe u tha sa ja paguanin manton, por dikush i jepte një dollar, dikush tjetër tridhjetë lekë; ndonjëri përvishtë buzët e nuk i jepte pazar fare; kurse ajo kishte menduar gjithë natën që mantua e saj, të paktën do t'i bënte pesë dollarë, se ishte me të vërtet e mirë, shumë pak e fërkuar, pa i dalë ngjyra asnje grimë dhe pa asnje njollë.

Erdhi rrëth gjithë ditën.

Shumë ja muarën manton nga dora, e rrrotulluan sa andej këtej, e provuan në trup, po asnjeri nuk i dha më shumë se tre dollarë. Vëtëm një

burrë ja pagoi njëqind lekë, po edhe ai iku e se nga u zhduk, sikur të qe penduar.

Tërë paraditën i pati zili ata ose ato gra që, pa u drojtur fare, thërrisin për të têrhequr myshterijt: «hajde, kush do një xhaketë?» «Një pallë çizme të mira!» »Një pallto e madhe burrash!« «Të lira fare!». . . Por kur e pa se mezi i ditës kaloi e nuk po e shiste dot, filloi edhe ajo të thërriste me zë të ulët kur ishte pranë ndonjë gruaje: «Urdhëroni një manto. . . Urdhëroni një manto të lirë e të mirë». Dhe ecte si e këputur me manton hedhur në dorën e majtë. Në fytyrën e saj, në ecjen, në zërin, njerëzia shihnin lodhjen e dëshpërimin e një njeriu që i ishte cfilitur zëmra e i ishte bërë si një top eshkë.

Pazari filloi të prishej. Njerëzit po rrallohen. Në dimër errët që më ora katër dhe ora po shkonte tre. Ku të vinte pa u shpurë gjë fëmijëve? Edhe për pak nata do të binte mbi qytet e ngarkuar me llahtar për shpirtin e saj të rrudhur nga hidhërimi. Me sytë e kredhur në bregë e saj të fshehtë, zuri të kërkonte ata myshterij që i kishin dhënë shtatëdhjetë e pesë lekë, por nuk po i shihte. Tani ata që i afroheshin i jepnin një çmim si për ta tallur, sikur ta dinin sa nevojtare ishte e që do ta shiste medoemos atë ditë. Në fund, pak para se të errej, iu afrua një burrë e i dha tetëdhjetë lekë. Ajo e njoihu, ishte ai që ja kishte paguar njëqind paradite. Pasi u hëngër me të në pazar një copë herë, burri ja pagoi nëndëdhjetë e u nis të ikte. Atëherë ajo i thirri të shkonte ta merrte, dhe i tha duke kërcitur dhëmbët nga të ftotit: «Po ti më dhe njëqind në mëngjiez, pse m'i mbajte ato dhjetë lekë?» Burri qeshi pa të keq: «Tani i thonë aksham pazari. Haj-

de, do ma japësh aqë sa të pagova apo jo, se ika; dua të fitoj edhe unë». Shega ja lëshoi në dorë, mori paret i futi në gji e iku. Duke u këthyer në shtëpi, ahore e ndjeu se kishte mardhur. Duar e këmbë i qenë bërë koçan. Barku i ishte ngjitur pas kurrizit nga të pangrënët. Ndjeu se po i merrreshin mënd e po i dridheshin gjunjët. U kthyen në furrin më të parë, bleu një simite një çerek leku e hëngri thatë dhe duke ngrënë mallkoi veten: «Më martë mortja mua kur ha bukë vetë e fëmijët presin pa futur gjë në gojë që mbrëmë!» Shpejtoi këmbët që t'u shpinte të vegjelvë bukë, gjizë, presh, fasule. . .

Kur vajti në shtëpi, një orë pasi kishte rënë nata, e vjerra, me të parë zimbilin plot e Shëgën pa manto, tha me vete, me një zë që sa mezi i delte përmes regetimave të zëmrës:

— E paska shitur, korba!

Fëmijët, të heshtur, vështruan me lakminë e të uriturve gjërat e mira që u kishte prurë nëna në shportë, po asnjeri nuk zgjati dorën drejt tyre. Dhe kur u ulën në sofër, hëngrën bukë të nemitur e të ndrydhur si gjithmonë, sikur t'ishin ata fajtorët për vojtjet e nënës. Kurse nëna i nxitëte me zë përkëdhelës, për t'u hequr mërzinë:

— Hani, shpirtet e nënës. Ha Gimi. Ha Vëra. . .

## **ANKIM TE NËNPREFEKTI**

Dyl Abazi atë natë nuk bëri më shumë se tri orë gjumë. Në mëngjez u ngrit sapo zbardhëlloi dita. U vesh shpejt e shpejt dhe i thirri së shoqes:

— Grua, më hidh një gjysëm buke të trashë, më mbush edhe atë shakulloren me gjizë, se do të ikij unë.

— Ku do të vesh? — e pyeti ajo përgjumësh me zë të trëmbur e si e habitur.

— Do të vete në Grëmsh të qahem te nën-prefektu.

Ajo e vështroi një çast e menduar. Sytë e saj gjithë pikëllim thoshin: «Ti po shkon, or burrë, të qahesh, po a do të bësh dot gjë?» I preqatiti bukën dhe pastaj mori një shportë e mbushi me vezë. «Ke këtu», — i tha, «shtatëdhjetë kokrra. Shpjeri në dyqan e na i merr pëlburë. I kemi lakuriq këta fëmijë. Hap sytë mos i thyesh, se i kam mbledhur kokrra-kokrra». U zgjuan edhe fëmijët dhe u ngritën të shkonin kush të ruante lopën, kush me ato pesë dhi e kecra.

— Baba, — i thirri Meti i vogël, — më bli një bilbil në Grëmsh si atë të Cenit. Me dy vezë merret një bilbil, kaqë ja kishte blerë edhe Cenit babaj.

— Merri djalit një bilbil, — i tha e shoqja Dylit, — se ka sevda, të gëzojë. Ua kam hequr nga goja fëmijëve ato vezë.

Hodhi trastën e bukës më krah, shportën me vezë në një dorë, shkopin në tjetrën dhe u nis Dyli për në Grëmsh. Rrugës shkonte në mend bisedën që do të bënte me nënprefektin, ashtu siç kishte biseduar me të gjithë natën, bile edhe në ëndërr ato tri orë që fjeti:

«Zoti nënprefek! (Po si është më mirë t'i them, zoti nënprefek apo kajmekan efendi?) Zoti nënprefek!

«Urdhéro.

«Unë jam Dyl Abazi nga Gunabardha.

«Qofsh shëndoshë. C'hall ke? Urdhéro e tri. Pse je munduar zotrote?»

Nënprefekti, një burrë i hijshëm, ulur rëndë-rëndë në kolktuk, me fytyrë të qeshur, është gati ta dëgjojë me vemendje? Dyli lë shportën në fund të dhomës, trastën e bukës, edhe shkopin, e ulet në sëndallie.

«Kam ardhur të të qaj një hall të madh, zoti nënprefek. Nuk kam ku ta përpjek kokën, veçse te zotrote. Kam një javë që po vij vërdallë poshtë lart, sa te kryetari i komunës, te postkomandanti i xhandarmërisë.

«Po si e ke hallin, or zoti Dyl? Pa urdhéro e folë.

Nënprefekti vë atë dorën e bardhë topolake prapa veshit, si e si ta dëgjojë më mirë Dylin, që të mos i shpëtojë asnjë fjalë e tij e t'i hyjë sa më thellë çështjes, që të vejë haka te i zoti. Dyli merr zemër e fillon të flasë i lirshëm si me një baba të mirë.

«Siç e di, zoti kajmekam efendi, për ne fsha-

tarët një ditë tani në maj vlen sa një dynja. Se i thonë maj, nënprefek efendi; vakt maji, vakt zjarri. Sot ha kau kanë. Shokët e mi po mbjellin, kurse unë i varfëri...

«Ke të drejtë, ke shumë të drejtë. Po folë. Pse na ka vënë lartmadhëria ne këtu? t'i qajmë hallet popullit, ta ndihmojmë, të mos vuajë fakirfukaraja...

«Ymër iu dhëntë zoti, lart madhërisë edhe juve me gjithë fëmijë e ç'kini për zëmër, zoti nënprefek.

«Falemnderit, falemnderit.

Nënprefekti vë dorën në zemër e përkul kryet.

«Tani urdhëro e më dëgjo, zotrote kajmekam efendi:

«Urdhëro, folë.

«Këtë dimër, ai kushëriri im, Zylfua, nuk e njeh zotrote, po vdiste për bukë. Pa ç'pa, sa t'i vdisnin kalamajt, e shiti arën që e kemi ndarë për gjysëm, se ne jemi djem xhaxhallarësh me të. Arën e bleu Myftar beu. Doja ta blija unë i mjeri, po me se! Një lopë kam, hem për qumëشت hem për të lëruar, dhe pesë dhi e një gomar.

Nënprefekti dhimsurohet për Dylin, Dyli e vështron te me plot respekt dhe merr kurajo akoma më shumë.

«Mirë që e bleu Myftar beu, ta trashëgojë me vetë e me djem, po mua të mjerit ç'ka që më bie më qafë. Më tha që t'ja shisja edhe unë pjesën time, po unë nuk desha. Kur, para një javë, për tërë natën, i shtyn kufitë, i fut nja dy lehë brenda në arën time, e mbjell arën, e kur vete unë në mëngjez, ç'të shoh! zura kokën me duar! «Mos bëj këmbë tëhu, se të vramë!» më thanë

344 27296  
MINISTERIA L SHTRITËS  
BHMVSHIN

djemtë e Myftar beut, kur desha të vija të merresha vesh me ta. Unë atë arë kam e perëndinë. Po më iku ajo, më vdiqën fëmijët për kotheren e bukës. Kurse kryetari i komunes e postkomandananti i xhandarmërisë, erdhën në fshat, e panë arën dhe vajtën ja shtruan me gosti te Myftar beu e shtinin më nishan me pushkë. Prandaj, vër dorën në zemër zoti nënprefek, mejto për ata fëmijë që kam lënë në shtëpi dhe bëj emër të vejë e drejta në vend. Unë s'jam marrë kurrrë me qeveri, zoti nënprefek.

Kajmekami nxehet. Fytyra i skuget. «Braf» ngre telefonin dhe urdhëron:

«Alo! Kush je? Kryetari i komunes? Dëgjo: Ç'janë këto turpe që bëni, ti e ai Myftar beu? Pse nuk ja qan hallin fukarasë ti? Ç'ruan ti aty, lopët a?! Léri llafet! Dëgjo këtu: Kufitë e arës së Dyl Abazit të venë në vënd. Dylin e kam këtu në zyrë. Kur të vijë Dyli në fshat, kufitë t'i gjejë atje ku kanë qënë! Asnjë fjalë nuk dua! Po s'u bë kjo, je i pushuar nga puna!

«Zoti ju dhënë ymër e kësмет, zoti nënprefek, ty e atij që të ka vënë ty këtu! — uron Dyli. E tok me të, duke ja mbledhur dorën e butë me të dy pëllëmbët e tij të çara si zhapë lisi, dhe duke u përkulur pastaj, merr shportën me vezë, trastën, shkopin e shkon në pazar.

Pesë orë mbante Grëmshi nga fshati i Dylit. Ato pesë orë udhë ai i bëri pa u lodhur e pa e ndjerë fare, duke biseduar e stërbiseduar me nënprefektin si me një mik të zemrës, i cili ja qau hallin, e ngushëlloi dhe më në fund i dha të drejtën që i takonte; kurse të liqve u tregoi vendin. «Ja, të tillë njerëz e kanë hallall bukën e qeverisë, që nuk i lënë të liqtë t'iu hipin në qafë të tjerëve».

Kur arriji në Grëmsh, Dyli pyeti:

— Ky është Grëmshi?

— Ky, — i thanë.

— Po dyqanet, hotelet, shkollat, shtëpitë e kasabasë ku janë?

— Ç'kasaba, mo drëzi!

— Po nënprefektu ku e ka zyrën? — pyeti kafexhinë.

— Ja, ajo atje, — i tha ai duke ja treguar me kokë.

Dhe Dyli u nis. Te dera e nënprefekturës, — një ndërtesë e vjetër që në kohën e qyqes, — e ndaloi një xhandar me ca mustaqe të verdha të dredhura si brirë dashi.

— Ej, ku vete ti?! — i foli ai i ngrysur.

— Kam punë te nënprefektu.

Xhandari i pa shportën në dorë dhe ja bëri me kokë:

— Shko.

Nja dhjetë a pesëmbëdhjetë fshatarë të tjere, që prisnin te dera jashtë, e ndoqën Dylin me sy ziliqarë.

— Po s'u lye rrota nuk lëviz qerrja, jo! — tha njeri nëpër dhëmbë.

Dyli ngjiti shkallët dhe priti gjersa hyri e doli nga nënprefekti portjeri, një plak i shkurter, që e lajmëroi. Pastaj i tha Dylit:

— Urdhëro.

Dyli hoqi opingat përjashta, dhe si hyri benda, la në qoshen e dhomës shportën, trastën e bukës, shkopin e po rrinte në mes të dhomës me qylafin ndër duar. Nënprefekti, një burrë i zymtë që s'e kishte shokun, as që e ngriti kokën ta shihte në fytyrë. I nguli sytë shportës një copë herë, pastaj e pyeti me vetulla të rrudhura:

— Ç'ke atje? Qershi?

— Jo, ca vezë.

— Të freskëta?

Dyli nuk dinte si t'i thoshte.

— Po, ashtu janë, ashtu...

Nënprefekti zgjati dorën, ngriti një zile nga ato që iu varin mushkave, me një bisht prej druri, dhe e tundi disa herë. Hyri portjeri plak duke u përkulur.

— Thuaji xhandar Markut të vijë lart.

Hyri Marku me gjithë mustaqe.

— Mere atë shportë, — e urdhëroi nënprefekti dhe shpjere...

Xhandari mori shportën e iku. Dyli kujtoi se mos nënprefekti u zemërua me të pse e futi shportën brenda dhe tha me vete se nënprefekti urdhëroi ta çonin më ndonjë vend tjeter që të mos ndotëz zyra, meqënëse shporta kishte edhe kashtë. Kur të delte do t'ja jepnin, sigurisht duke e qortuar, se zyra e nënprefektit nuk ishte furrrik pulash.

— Më fal, zoti nënprefek, — tha ai, — se unë ato vezët, s'desha... po...

— S'ka gjë, s'ka gjë, mirë bëre, po pa hë, folë, ç'kishe ti?

— Unë, zoti nënprefek...

Dyli i harroi fare fjalët që kishte prebatit për t'i thënë nënprefektit. «Dreqi i mori edhe ato vezë! Ç'më bëri ajo djall grua! Shiko si i ka rrudhur vetullat nënprefeku!».

— Unë, zoti nënprefek, kam ardhur te zotro...

— Shiko, bjeri shkurt.

Vetëm atëherë nënprefekti e ngriti kokën dhe Dyli vuri re sytë e tij të mbufatur për gjumë. Ai gjithë natën kishte lojtur kumar. Ishte

ngritur më ora dymbëdhjetë të ditës, kishte ardhur në zyrë mos i merrte ndonjë para drejtorit të financës, se i kishte lënë natën e kaluar të gjitha ç'kishte patur, e do të shkonte t'ja niste përsëri pokerit me rrethkomandantin, gjykatësin e të tjerët.

Dyli u mudua t'ja shkoqiste të gjitha ç'kish-te për t'i thënë, po as ai vetë s'mori vesh ç'i tha, se nënprefekti një e më dy e ja priste: «Bjeri shkurt! bjeri shkurt!»

Më në fund nënprefekti iu përgjegj me zë të vrazhdët, duke vështruar nga dritarja jashtë:

— Mirë, shko. Kjo punë i takon gjyqit. Nuk i takon kësaj nënprefekturë...

Kur dolli te porta jashtë, xhandar Marku i dorëzoi Dylit shportën. Dyli futi dorën, trazoj kashtën dhe nuk gjeti atje asnjë vezë.

— Ku janë vezët? — pyeti xhandarin.

— Ja shpura zonjës së zotit Nënprefekt. Më tha: të faletnderit shumë. Kishin qënë shumë të freskëta.

Dyli mbeti i shastisur, hodhi disa hapa nëpër lëndinën e gjelbëruar përpëra godinës së nënprefekturës, çdo gjë që kish përpëra syve iu nxisterrë dhe tha me vete:

— Nuk kam ku ta përpjek kokën tanë gjetiu. Një shpirt ka për të dalë, një herë del ai i shkretë dhe le të më dalë atje në mes të arës, ku kam jetën e tetë frysmeve.

## HASANI I DERRAVE

Duhet të kem qënë jo më shumë se shtatë vjeç. Por të gjitha këto që do tregoj më duket sikur kanë ngjarë dje.

Si nga fundi i fshatit, buzë një përroi dhe pak më të çkëputur, ishte shtëpia e Hasanit të Mukes: Një kasolle e vjetër, kushedi që kur që ndërtuar, me furkat të shtrembëruara dhe e tërë kasolla që bërë lagje-lagje. Mënjanë, nga veriu, Hasani i pati vënë ca furka gardhit, që t'ia shtonë dhe ca ditët kasolles, sepse në dimër, kur frynte juga, mot për mot e shtrëmbëronte ca e nga ca.

— Do t'ju zerë ndënë vete kasolla, o Hasan,  
— dëgjoja që i thoshin pleqtë tanë, kur shkonin atje afér saj.

Hasani, gjithë i qetë, tek gdhëndëte ndonjë gjë në oborr, ndalte për një çast sqeparin, rrrotullohej e vështronte kasollën sikur ta pyeste: «E moj, si e ke hallin ti, do qëndrosh dot edhe këtë faqe moti apo jo?!» dhe pastaj përgjegjej pa e bërë qejfin qeder e pa i vështruar njerzit në syt:

— Jo, or vëlla, jo, nuk bie.

Por, edhe qëndrimi që mbante edhe mënyra

se si u përgjegj, ishte e tillë sikur donte t'u thosh:

— Mbani rrugën, limëni rehat në hallin tim.

Mua më bëhej zemra mal. «Ç'kanë këta me kasollen e Hasanit?!» pyesja me vete. Sepse kasolla e tij na tërhiqtë aqë shumë sa që më dukej sikur mos zot, po të shëmbej ajo, do të shëmbej edhe tërë gëzimi ynë. Ne, në verë, sa zbutej moti, shkonim andej nga kasolla e Hasanit, bënim kasollat tona, dhe loz nim xhiko-miko. Qamilja, e ëma e Hasanit, na nxirrte nga një dorë lajthi, dhe ato ne i kishim pér gjellë kur shkonim miq e zonja. Pa kur na duhej një çikëz miell pér të gatuar çupat bukë, Qamilja nuk iu thoshte kurrë «jo». Dhe çupat, n'ato poncat e vogla sa një tavëll cigare, na gatuanin kulaçë me mjellin e Qamiles. Atëhere në qershori piqeshin edhe qershijat e Hasanit, dhe ne i shpinim ndonjë sahan miell Qamiles apo ndonjë dorë kripë e hipnim hanim si në mallin tonë. Në dimër pastaj ngri-nim grackat buzës së atij përrojt pér të zënë cërrë e mullinja, dhe kur na mardhnin duart futeshim në kasollën e Hasanit. E shkreta Qamile ngrihej, ashtu dykaç sic qe bërë, na hapte vend, i hidhte edhe ca shkarpa të tjera zjarrit, flaka bu-bullonte, dhe ajo me ato duart e saja kock' e lë-kurë, na zinte duart me radhë e na pyeste:

— A u ngrohët ju bëftë nanaja juve?

— U ngrohëm, nana, u ngrohëm. — i përgjegjeshim ne, se nana Qamilja i thërrisnim, sic i thërresin gjyshes andej nga ne.

Sa zëmërbardhë ishin njerëzit e asaj kasolleje që anohej e s'rrëzohej! E zezë qe brënda, nga tymi e nga bloza, dhe e zezë e gati e kalbur qe edhe kashta nga jashtë, por njerëzit që jetonin në të e kishin zëmrën llagar. Hasani, një

burë qimeverdhë, afër të dyzetave, që s'mbaj mënd kurrë ta kishja parë njëherë të rruar, dukej i vrazhdët në të parë, por ai që akoma më zëmërbardhë edhe nga e ëma, nga e shoqja dhe të bijtë. E kisha plagë në zëmër dhe pyesja gjithnjë veten: «Po përsë janë kaq të varfër këta te Hasan! Këta janë kaqë të mirë sa s'kanë shoq në botë!» Doja t'i shihja të lumtur, po çfarë të bëja për ta?! Një ditë na pati ardhur një mik në shtëpi dhe më daroviti me dy lekë. I gëzuar ja tregova ato dy lekët një xhaxhajt tonë. Ai qeshi dhe më tha: «Aoo! po ti qënke bërë zengjin! Kush është si ti tani! Asnjë nuk është kaq i pasur sa ti në fshatin tonë!» E mbajta atë dylekëshe nj'a një gjysëm dite, sa i nxora sevdanë, dhe pastaj brodha e vajta te Hasan. Gjeta nana Qamilen e ja dhashë duke i thënë: «Nana, urdhëro merre këtë paranë që të bëheni zengjinë edhe juve». Ajo s'deshi ta merrte: «Jo bir, jo, se të flet jot' ëmë». Unë zura të qaja. «Po nuk më bën zengjin kjo, mor bir, jo!» zuri të më lutej nana Qamilja që ta merrja dylekëshen përsëri.

Kur mësova dhe u binda se me të vërtetë një dylekëshe nuk të bënte zengjin, më mirë të më paskësh zënë nënë vete mali që kishim mbi fshat, se unë kujtova që i shpëtova ata të Hasanit nga fukarallëku.

Një ditë, aty më të hyrë të marsit, kur kishin çelur thanat dhe ne presnim të vinte pranvera, të shkrinte dëbora dhe të shkonim të losnim nga kasolla e Hasanit, dëgjova të mëdhenjtë që fjaloseshin:

— Futet derri në shtëpi?! Ka kafshë më të mallkuar se sa derri?! Atij shikojti feçkën si e ka, dhe pastaj...

— Derri, ore! — ja priste tjetri, — po derri nuk éshtë as ka, as qën, as mi!... Ai bishtin e ka si tē miut, thundrat si tē viçit, tureçkat... Ai ka marrë njëçikë nga tē gjitha nishanet e kafshëve tē tjera, prandaj edhe éshtë i mallkuar.

Po kush ka futur derr nē shtëpi? Këtë nuk po e zgjidhja dot. Hyra brënda. Edhe atje po me këto fjalë nē gojë i gjej gratë.

— Korbi! Korbi; ja shiti shpirtin shejtanit!

— rrihej e përpiquej gjyshja.

Iu afrova te veshi dhe e pyeta:

— Kush moj nana?

— Hasani, or bir, Hasani i Mukes! — m'u përgjegj.

Kur më tha për Hasanin, sikur më ra pika e më goditi. Atëhere zura tē interesohem më shumë. As kisha parë e as dija c'ishte derri. Nuk arrija dot tē kuptoja pse ishte gjynah tē fusje derr nē shtëpi. «Të shkretin Hasan c'e paska gjetur!» menjtoja me vete. Më këpuntej shpirti për këtë Hasan dhe më dukej sikur u përbys bota. Doja tē bridhja tē vija ta shikoja një herë Hasanin si qe bërë ai nga derri që kishte futur nē shtëpi dhe c'bënин nana Qamilja, fëmijët, e shoqja. I merria me mend sikur ata kishin ngritur kujën, qanin e lebetitnin dhe sa mezi e mbaja tē qarët edhe unë.

Pyeta gjyshen:

— Qysh éshtë derri, moj nana?

Ajo mblodhi buzët, u shëmtua, u drodh e tëra sikur t'i paske dalë gjarpëri përpara dhe sa s'më volli në prehër.

— Ikë aman, ikë mos ma kujto! — m'u lut duke më bërë me duar që tē prapsësha.

E po kë tē pyes unë i mjeri tani?!

Prita si i drojtur, gjithë i lënduar, sa iu largua të pështirët gjyshes dhe prapë iu drejtova po asaj, duke e shikuar në sytë sikur t'i lutësha: «Aman shpëtomë», dhe e pyeta me zë fare të vdekur:

— Pse është gjynah, moj nana, po të futësh ashtu në shtëpi.

Nuk ja zura ngojësh emrin derrit, se më dukëj që vetëm emri e llahtariste gjyshen.

— Është gjynah, se është malukat i mallkuar.

— Kush e ka mallkuar?

— Zoti që e ka jaratisur.

Njëmijë pyetje zienin në kokën time tani: «Pse e ka mallkuar Zoti. Ai, Zoti, hëm e ka jaratisur vetë, hëm e ka mallkuar! Po pse xhanëm?! Po Hasani pse e futi derrin në shtëpi? mos i kanë vajtur xhandarët e i kanë thënë: «Fute këtë derr në shtëpi!» dhe ai e ka futur nga frika? Ç'do ta gjejë Hasanin këtej e tutje? do t'i prishtë kasollja? do t'i vdesë njeri? Qysh do të jetë ky derri vallë?» Dhe më e keqja e të këqijave ishte se nuk guxoja të pyesja njeri. Vetëm gjyshja s'ma prishtë kurrë, por po ta rëmoja edhe atë më shumë, kishja frikë se mos villte. I brengosur, i ruaja njerëzit në syt mos thosh njeri ndonjë fjalë të mirë për Hasanë, që të më ngrohej njëçikë gjaku. Dolla përjashta. Te sheshi i arrës qenë mbledhur nj'a njëzet burra e të rinj. Të gjithë rrinin më këmbë, vështronin tatëpjetë nga kasolla e Hasanit e fjaloseshin.

— T'i shikoje, ore, t'i shikoje si ja bënин:  
«yyyy».

Njeri pështynte andej, tjetri këtej.

Hyra në mes tyre e me sytë dollap vështroja sa njerin tjetrin.

— A ishin kaqë sa ky ore? — pyeti njeri dhe më tregoi mua. Unë u drodha i téri se m'u duk vetja derr.

— Sa peshon ai, ai s'është as pesëmbëdhjetë okë! — u përgjegj tjetri duke më shikuar, — kurse ata mund të vinin nga tridhjetepesë okë secili.

— Lum këta që i paskan parë, — mejtoja. Pastaj pyesja me vete: Po pse si njeri qënka derri? pa dale të dëgjoj të tjerët.

— I mori Hasani, i lau në përrua, i bëri pëllumbë të bardhë, hëm dosën hem derrin, dhe i mbante përpara duarsh si ndonjë bir të vetëm.

— Ha! ha! ha! — qeshnin të rinjtë.

— Sa kohë ndenji andej nga Korça Hasani?

— Ndejti nj'a tre muaj dhe më në fund na pruri derrat, sa pér të na molepsur fshatin.

— Të vemi t'i themi t'i heqë nga shtëpia.

— Kush vjen me mua të vemë t'i shohëm-thirri një djalë nj'a pesëmbëdhjetë vjeç.

— Tashti u err, nesër vemi.

Kur hyra brënda i thashë gjyshes se të nesërmen çunat e fshatit do të venin të shihnin derrat e Hasanit. Dhe këtë nuk ja thashë kot. Doja të dija se ç'do të thoshte sikur të via edhe unë. Ajo, sikur të ma paske blerë se ç'kisha në mëndje, m'u kanos:

— Shiko, se mos vesh edhe ti! se s'të qas në rrrobat të flesh me mua këtej e tutje!

Tërë biseda e asaj darke qe mbi derrat e Hasanit të Mukes.

Kur ramë të flinim u bëra kular në gji të gjyshes si çdo natë dhe u shtira i fjetur, por gjumi nuk më zuri kushedi pér sa kohë. Llojilloj mendime bluaja me vete. «Të vete apo të mos vete te Hasani nesër?». Me këtë mendim mund që u mora nj'a një orë. Kur e vendosja të via, filloja

e bëja planet: «si do gënjeja që të ikja e nga do shkoja pér të mos më pikasur njeri: «Nga vresh-ta? jo. Që andej dukesh kur kapërcen shtegun. Nga Brinjat? jo edhe që andej, se të shohin që nga qoshku. Është ca larg, por do t'i bie nga vorrezat, të dal në përrua e pastaj, pérrojt e pérrojt dal mu pérpara kasolles; nëpër ferrat e shelgjet asnjë njeri nuk do më vërë re». Më në fund, i tërë ky plan, më rëzohej, sepse thoshja me vete: «Po sikur, të më shohin! Po sikur të ketë njerëz te Hasani e ta kallzojnë gjyshen, ku do të futem unë!» Kisha një ankth në zemër që sa vinte e më shtohej. Gjyshja po gërhiste. «Shyqyr! e zuri gjumi!» Tani pshëritija pa droje që të lehtësos-hesha. U largova prej saj, u shtrita më kurriz, me sytë nga tavani, që nuk dukej në terrët, e prapë vrisja mëndjen se si do të bëja të nesërmënen.

Gjer atëhere kishte shumë shprehje që nuk u dija kuptimin. Ja, p.sh., vinte dikush nga pa-zari dhe e pyesnin:

— A u poqe me filanin?

— U poqa, përgjigjej tjetri.

Mirë, thoshja unë me vete, si u poqën këta? mishi, buka... këto piqen. Këta, po të ishin pje-kur, s'do ishin gjallë!

Po kështu edhe atë natë zjeja në lëkurën ti-me që të kuptoja shprehjet e gjyshes: «I ziu, ja shiti shpirtin shejtanit! Futi zjarrin në shtëpi! Do ta djegë zjarri i xhehnemit korbin e zi!...» Po pse ja shiti shpirtin shejtanit Hasani? Pér bukë? Apo pér të blerë derrat? Mirëpo derrat nuk qënn-kan gjë e mirë, atëherë pse ta shiste? Sa para do ta ketë shitur? Apo nuk e ka shitur me para? Ndofta, shejtani që është aqë i keq e që e ka shtë-

pinë nëpër përrrenjtë, ka derrat që qënkan edhe ata të këqij dhe kështu i ka dhënë Hasanit dy derra e i ka marrë shpirtin. Por, po t'i marrin shpirtin njeriut, ai vdes! Hasani s'ka vdekur! Si bën ai, hem shpirtin e ka shitur, hem është i gjallë? Apo ndofta ka mbetur as i gjallë as i vdekur? Mendoja kështu dhe më dukej sikur e shihja gjithë atë Hasan të gjatë: me kraharorin me lesh, të hapur, të shtritur në mes të kasolles me sytë mbyllur, krahët hapur, gojën hapur, ashtu siç e mbaja mënd që e kishja parë në verë tek flinte mënë hijen e qershive. E lija këtë se nuk e shpjegoja dot dhe mundohesha të kuptoja se ç'është ky zjarri i zhehnemit që do të digjte Hasanin. Nga përrallat e gjyshes e merrja me mënd ç'ishte zjarri i xhehnemit. Mirëpo ajo më kishte thënë se xhehnemi është njëmijë pashë nënë dhe. Qysh do të delte ky zjarr e do ta digjte Hasanin. Ose, qysh do të vinte Hasanai gjer aqë thellë, gjer të përpiqte më zjarrin e xhehnemit? Kushedi! mund të hapet dheu atje ku ka kasollen Hasanin, të kércejnë flakët e zjarrit të xhehnemit përpjetë, ta përpjnjë dhe të mbylljet prapë dheu. Bubu! po sikur t'i ngajajë sot natën kjo gjëmë! Zëmrën e kisha plagë, gjyshja gërriste dhe bënte një gjumë të qetë, si kurrë ndonjë herë. Më vinte inat: si flinte ajo kaqë rehat, kur Hasanin, nga shkaku i derrave, do ta digjte zjarri i xhehnemit! Pse nuk ngrihej i tërë fshati të vinte ta shpëtonte! Për një çast m'u duk sikur pashë si nga fundi i odës Hasanin tek digjëj në një zjarr të madh. Dhe thirra:

— Gjyshe! gjyshe!

Ajo, nëpër gjumë, me sy mbyllur, m'u përgjegj.

— Zgjohu, zgjohu! — i thirra gjithë frikë.

— Kur do ta djegë zjarri i xhehnemit Hasanin?  
— Sa budalla! Fli, mos u bëj i marrë! Kur të vdesë, — më tha gjyshja.

— Po kur do vdesë Hasani, sot? Do ta hanë derrat natën?

— Jo, o budalla, jo! Kur t'i vijë vdekja do të vdesë. Kur të bëhet plak, plak fare, më pak se xha Laska.

Më pshtolli në gji e nuk mbaj mënd si më zuri gjumi. Veç di që tërë ajo natë më kaloi me ëndërratë llahtarëshme.

\* \* \*

Kur u ngrita në mëngjes herët, apo hapa systë, shikova një herë rretheqark se ku isha. Pastaj i vështrova njerëzit në sy si për të hetuar: ç'do të thoshin për Hasanin, për derrat; ç'do të kishtengjari gjatë natës te Hasani...

Njerëzia kishin hallin e tyre secili. Nëna po na zjente térhanin. Babaj kërkonte një gjilpyer për të qepur qapushinat e qeve, se do të fillonin ugaret. Gjyshja po bënte përsheshin. Ah, zot, mendova me vete, sikur të ketë shpëtuar Hasanin i mjerë nga derrat! Të pyes apo të mos pyes përtë?! Po sikur të më thonë ndonjë lajm të keq?!

— Mos ikë, se do të hash bukë, — më thirri nëna.

— Do dal njëcikë përjashta, — i thashë si me zë lutës që të mos më pengonte. Doja të delja jashtë një minutë e më parë, se s'më durohej, gjersa të merrja vesh për Hasanin. Fshatarët delnin nga shtëpitë: kush lëshonte bagëtinë, kush qetë e lopët, kush shkonte për dru. Vija re mos.

ishte ndonjëri i tronditur, porse të gjithë ishin si gjithmonë. Si nuk i zë meraku këta për Hasanin? pyesnja me vete. Zëmrën e kishja plagë. Dolla te bajamja, nga ku dukej shtëpija e Hasanit, dhe vura re që tymi shkonte përqell nga çatija e kasolles, nga ajo anë që kishte vatrën. Pas pak dolli nana Qamilja, mori një krahë dru përashta e i futi brënda. Ja edhe Hasani tek dolli në oborr përparrë kasolles e po shtrihet.

Kur hyra brënda, trahanaja qe gati. Ku më hapej goja mua për bukë! Bëra sikur hëngra e s'hëngra fare. Qysh durova gjersa ra dielli mirë e u ngroh moti! Doja t'ikja të vija te Hasani të shikoja me sytë e mij se ç'ndodhte atje. Mirëpo më dukej sikur të gjithë ma dinin këtë mendim të fshehtë. Shikoja gjyshen në sy, nënën, gjithë të tjerët, si ndonjë hajdut, për të kuptuar nëse po më ruanin ata mua se mos ikja apo jo. Mirëpo ata as që ma varnin fare. Megjithatë unë thoshja me vete: «Ashtu bëjnë gjoja sikur s'më ruajnë». Dhashë e dhashë, më në fund i thashë gjyshes duke mbajtur sytë përdhe, që të mos ma kuptonte shejtancun:

— Gjyshe, unë do vete për shkarpa.

— Shko, të keqen gjyshja, po mos u gris. Mos shko vetëm, merr edhe Asimin, Myrtezanë...

Ika si vjedhurazi e vjedhurazi, fill e vetëm; ikë e shiko prapa. I rashië qark e qark: nëpër selishtat, nga vorrezat, u futa në përrua e dolla te kasollja e Hasanit. Hasani kishte vënë një kërcu ndër shalë e po e gdhëndëte me sqepar për ta bërë govatë për t'u hedhur derrave në të. Pas kasolles, me shpatullat pshtetur në gardh, Cania i Myrtos pinte duhan. U ula më bisht karshi.

Hasanit dhe po e vështroja në syt për të hetuar ndonjë ndryshim, ndonjë dëshpërim, ndonjë merrak; por asgjë; ishte ai Hasan që kishte qënë ngasherë.

Kur më vuri re, pas një copë here, Hasanit më tha me atë zërin e tij të trashë:

— Shko brënda, or kolopuç, se qënke lagur e mos mardhësh. Ruhu, se mos të bjerë ndonjë bluashkë në syt.

Nga biseda e Hasanit me Canen nuk po kuptoja dot gjë, siç doja unë.

— Po sa i bleve, o Hasan? — e pyeti Cania.

— Një napolon çiftin.

— Me se i prure?

— I vura në gomar, nëpër koshat.

— Mirë ke bërë.

— Po janë gjë pa harç, or vëlla, — vazhdoi Hasanit, — e të bëjnë çirak. Nuk janë budallej bota që i mbajnë. Po ne na ka zënë sytë fanatizma. Unë i mora njëherë pa le të thonë bota ç'të duan. Vetë flasin, vetë dëgjojnë. Gojën e tyre dhe veshët e tyre i kanë. A e di si thonë andej nga fshatrat e Korçës? «Në ke borç e do ta lash, në je pa shtëpi e do ta bësh, mbaj derra të shpëtosh».

Qetësia shpirtërore e zakonshme e Hasanit sikur më lehtësoi edhe mua ca. Ata nuk po fjaloseshin më. U ngrita hyra në kasolle. Dy djemtë e Hasanit edhe çupa kishin vajtur pas gardhoses, në fund të kasolles, shikonin nëpër brimat e gardhit dhe cirreshin të gëzuar:

— Shiko, nana, shiko si po i hanë zhapat e kungullit! Hoho! hoho!

Sapo më pa, nana Qamilja më tha e gëzuar:

— Ke ardhur të shikosh derrat? Hajde të

keqen nanaja, hajde shikoji .

E humba fare. I dinë këta ato që më ka thënë gjyshja mua, apo jo? Po fjalët që thonë fshati? Të gëzohem edhe unë, që di gjithë ato gjëra për derrat, siç gëzohen këta, apo jo?

Kur m'u mësuan sytë në errësirën e kasolles, i pashë mirë derrat. Sytë i kishin të vegjël. Thundrat iu ndrinin, qimen e kishin të bardhë qumësht. Nuk ishin të shëmtuar aspak! Po ata që kishja parë unë një herë... dale... kur i kishja parë?... hë, po, natën në ëndërr. Oh, jo, derat qënkan të bukur!

Gëzimi ynë qe akoma më i madh kur hyri Hasani në kasolle, u hapi gardhocen derrave e i nxori jashtë në diell. Atëhere i pashë edhe më mirë, i preka edhe me dorë. Plot njerëz të tjerë nga fshati erdhën e i shikonin. Më vinte inat, se disa nga ata që ishin aty, në mbrëmje, te sheshi i arrës, kishin thënë gjithato fjalë; kurse tani s'thoshin gjë. Po më hante përbrenda. Doja të sigurohesha: është gjynah të futësh derra në shtëpi apo jo? U bë një copëz herë qetësi. Gjeta rastin dhe e pyeta Hasanin:

— A është gjynah, o xhaxha Hasan, po të futësh derra në shtëpi?

Ai qeshi; edhe shumica e atyre që qenë aty ja plasën gazit me të madhe.

— Ai që e ka për gjynah, le të mos i fusi, or bir, — m'u përgjegj Hasanin:

— Po ty tani nuk do të të japi njeri nuse për djemt, se ke derra në shtëpi, — i thashë unë, se ashtu pata dëgjuar.

— Sa të më bëhen mua djemt për të marruar, kushedi q'bëhet. Unë dua bukë të ha sot. — Pastaj i ra shpatullave djalit të tij, që kishte

pranë dhe vazhdoi: — Hipur në dërrt do t'ua sjellë babaj nuset këtyre.

E unë mora me mënd një derr të madh sa një kalë, me një nuse me duvak hipur përsipër, që e mbanin dy veta nga krahët.

— Po zjarri i xhehnemit a do të të djegë ty xhaxha Hasan? — i thashë, se kjo më brente më shumë.

Sa pata mbaruar pyetjen unë, njeri nga derrat (të cilët i kishin vënë në mes e po i bënин sehir) derdhi ujët.

Hasani qeshi me të madhet e ja bëri me gisht nga derri:

— Jo, nuk do më djegë, se e shoi derri me sh...

Kur e pashë aqë të pameras Hasanin, u lehtësova fare, e nga gjëzimi që ndjeja për të, u harrova gjithë ditën te kasolla e Hasanit të Mukes. Në shtëpi më kishin kërkuar, por u kishin thënë që isha atje dhe nuk qenë bërë merak pastaj.

Në mbrëmje u kujtova të vija në shtëpi.

\* \* \*

Duke u kthyer për në shtëpi, në të përpjetën e Brinjave, më erdhi ndër mend gjyshja. Qysh do të më presë vallë? Do të më flasë apo jo? Po pse të më flasë, atje erdhën i gjithë fshati? Unë do t'i tregoja asaj se ujët e derrit e kishte shuar zjarrin e xhehnemit... Megjithatë, sa më shumë që i afrohesha shtëpisë, aqë më shumë po më rrihte lukthi.

Gjyshja më priti me këmbët e para. Ishte

vetëm te porta e jashtme, ndenjur në sofat, dhe kur më pa thirri:

— Ku ishe mor i zi, te derrat?!

Unë iu afrova, hem me frikë hem me shpresë ta zbusja, duke i treguar ato që kisha parë e dëgjuar. Por ajo më vuri në kërthizë majën e shkopit ku mbahej, dhe më sokëlliti:

— Prapsu njëherë, prapsu! A i ke zënë derrat me dorë?

Si t'i thosha «nuk i kam zënë», por edhe si t'i thosha «i kam zënë»?!

— Upupu! — u lebetit ajo, ç'ka bërë faqeziu, ç'ka bërë! Ikë tani, nuk të dua më! Nuk do të flesh më me mua! Pu-pu-pu! — zuri hundët — ti vjen era derr! Estrafkulla! estrafkulla! — Luajti nga vendi.

Ngriva më këmbë, me buzët vesh më vesh, për një copë herë dhe e shikoja gjyshen me sy lutës mos mëshirohej njëçikë. Por kur e pashë se ajo nuk po më afronte dhe vazhdonte të cirrej e të lebetitej, atëhere ja plasa të qarit:

— Obobo! do më djegë zjarri i xhehnemit moj, do më djegë zjarri i xhehnemit! Obobo, unë i ziu! Ku të vete unë korbi, moj?!

— Merre! — i thirri gjyshja nënës po me atë zë kanosës, — laje të tërë, hiqja rrobat, finjosja, se na pruri erën e derrit në shtëpi zuzari!

Kaqë u bëra merak e kaqë më hyri frika e zjarrit të xhehnemit, sa s'kish burrë të më pushonte. Sytë e zgurdulluar, me të cilët më priti gjyshja te porta, i hidhnin poshtë të gjitha ç'më thoshin pastaj «jo s'ka zjarr xhehnemi, jo ti s'ke bërë gjë». «Ja edhe unë do vete nesër t'i zë me dorë», më thoshte babaj, e të tjera e të tjera.

Nga tē qarët e shumë edhe natën nē gjumë kisha psherëtitur. Flija me èndrra tē llahtarshme. Brenda një jave u liga e u treta. Një ditë erdhi hoxha, Kasëm efendiu, e i tha gjyshes:

— Nuk èshtë gjë, moj xhiko Hysnije, jo. Kurani thotë që vetëm shpatullën e djathtë tē mos ja hash derrit, gjithë tē tjerat janë hiçë.

Gjyshja ishte më fanatike se hoxha, por a pse i tha Kasëm efendiu ashtu, a pse u bë merak pér shëndetin tim, u detyrua me atë pleqëri, më mori mua pér dore, shkuam bashkë te kasolla e Hasanit, i pa edhe ajo derrat dhe kështu u binda unë që s'do tē më digjte zjarri i xhehnemit.

E kam mu si tani pérpara syve Hasanin, kur qeshte me gjithë shpirt e i delnin ata dhëmbët e bardhë si thelpij bajame dhe i thoshte gjyshes:

— Kur tē bëj pastërma nga derrat, do tē tē bie edhe ty një kole (soxhuke) tē mirë, moj xho Hysnija.

Ajo bënte sikur villte.

Mua më dukej sikur kisha fituar një luftë tē madhe e sikur kishja nxjerrë një inat tē fshehtë që kishja karshi gjyshes.

— Ohoho, — thoshja me vete, — ja edhe kjo erdhi e i pa derrrat! Edhe këtë do ta djegë zjarri i xhehnemit tani!

Pas nj'a dhjetë ditësh erdhi dita e verës. Fëmijët duallën ozi e bozi. Kur vinin te Hasani ata këndonin si me tallje:

*Ozi e bozi,  
Dolli matrallozi*

*Sa lesh  
Mbi tre desh,*

*Aqë derra do të kesh,  
Sa lule  
Në Tomorr,  
Aqë dera në oborr.*

— Mirë, ju bëftë nanaja, mirë, uratat tuaja na zënçin — iu thoshte nana Qamilja qejfpaprishur.

Mua më vinte inat. Ah, që s'ishja i madh sa Hasani, pa do t'i zhdëpja në dru të gjithë.

Në verë, Hasanit të Mukes nuk i thërrisnin më si më parë, por prapa krahëve të tij i thërrisnin: Hasani i Derrave.

Fëmija e fshatit, kur shikonin djemt e Hasanit rrugës apo kudo gjetkë, këndonin si me kor:

*O Hasan i Derrave,  
Lësho derrat ferrave,  
Ferravet Mevlanitë,  
Jepja shpirtin shejtanitë!*

Kur ishte ndonjë grup të vegjlish, unë, djali i madh i Hasanit, Rama, që ishte nj'a tetë vjeç dhe Sala, ai m'i vogli, sa unë, vinim e ua shkulnim veshët e ua këpusnim edhe nga një shullare. Po kur kishte më të mëdhenj, zjenim e s'pëlcisnim.

## LËNDODHET NJË PLAGË E VJETËR

Mëbasdite maji. Ora e madhe në sallon ra pesë herë me radhë. Shpresa, siç qe mbështetur në dhomën e gjumit, duke lexuar volumin e dytë të romanit «David Kopperfildi» të Dikensit, e mbylli menjëherë librin. Për të mos i humbur faqja ku kishte arritur, mbajti atje gishtin tregues dhe po mendohej me sytë ngulur në pikturën që qe vendosur në faqen e murit përkundrejt. «Pa dale» tha me vete, «sa ra ora kështu? Pesë. Po, pesë. Ç'punë kisha unë në këtë orë? Ah, sa shumë më rrëmben kjo Anjezia! Harrova fare ku jam! Hë, tamam, e gjeta. Në ora pesë i kam thënë Dritës se do isha atje për të vajtur bashkë të shohim filmin «Salambo». Pupu, si më iku kjo kohë kështu pa e kuptuar! Po të mos i mbetej hatéri shoqes, Shpresa nuk do të shkonte sot në kinema dhe do të vazhdonte leximin e romanit që kishte në dorë, sepse pat arrijtur në pjesën ku Davidi vete te Anjezia e bisedojnë të dy dhe nuk dinte si do të zhvillohej biseda më poshtë, do t'i çfaqnin dashurinë njeri-tjetrit apo jo. E palosi një ceptë të fletës, e vuri librin mbi komodinë, duke bërë pakëz më tej abazhurin, dhe u çua shpejt e shpejt që të bëhej gati të shkonte te Drita. Tek vinte rreth të gjente bluzën apo fustanin, i bëhej sikur i shihte ata të dy — Davidin e Anjezen, —

që bisedonin aty diku, më ndonjë cep e diç ndjente  
në zemër.

U vesh e u kreh e nxituar dhe shkoi te Drita.

— Drita, më fal, se u vonova. Po lexoja David Koperfildin dhe...

— S'ka gjë, s'ka gjë. Nuk më sheh! Edhe unë nuk jam bërë gati. — Drita i tregoi robëdëshambrin që mbante akoma veshur. — Mirë bëre që u voneve se edhe unë tani sapo i mbarova së kore-gjuari hartimet e maturantëve. Pastaj, ka kohë. Gjer në ora shtatë që fillon filmi... Ja, humbëm vetëm shëtitjen. Po si më the? Ishe në atë pjesë ku Davidi shkon e bisedon me Anjezen? E di ç'ndodh pastaj?...

Shpresa këceu përpjetë:

— Ah, të lutem, Drita! Mos ma trego si vazhdon më tej, se dua ta lexoj vetë.

— Mirë, s'po flas. Po ti do të mërzitesh sa të bëhem gati unë. Do të të jap albumin ta shohësh?

— E kam parë.

— Ç'të të jap unë e shkreta! Ti je lodhur, se kë lexuar gjithë pasditen, pa do të të jepja tani një hartim të një nxënësi. Më ka bërë shumë përshtypje. Diçka e jetuar, diçka e ndjerë, diçka e dhëmbëshme, e sinqertë... Oh, sa më bëri përshtypje ai hartim, moj Shpresa!

— Po nëma njëherë ta lexoj, se edhe unë mësuese e letërsisë jam. Më bëre kureشتare me këtë hartimin e nxënësit tënd, — foli Shpresa si me shaka e i kërkoi hartimin, me qëllim që të merrej me një punë gjersa të «nisej e stolisej» shoqja e saj.

Shpresa lexoi në krye temën: «Tregoni një nga kujtimet tuaja që ju ka lënë më shumë vragë në zemër», dhe ngriti kokën e i tha Dritës:

— Temë interesante u ke dhënë.

— Lexoje, lexoje me vëmëndje, mos përto. Ti ndofta bën shaka, po unë e kam seriozisht kur të them që ja vlen barra qiranë ta lexosh.

Në këtë hartim, maturanti i shkollës 11 vjecare «8 Nëndori» shkruante.

«Ishte shkurti i vitit 1943. Bënte ftohët. Jashtë kishte rënë dy pëllëmbë dëborë. Babai, vëllezërit, kishin shkuar në punë. Nëna pat vajtur në pazar. Atë ditë nuk më lanë të vija në shkollë, se më dhimbnin bajamet. Nëna, para se të shkonte, më porositi:

— Gimi, të keqen nëna, mos dil përjashta, se je i hazërt, Rri këtu, ngrohu pas zjarrit. Hap ndonjë libër e mëso. Nëna ta ka bërë zjarrin të mirë. Po u shkrehën urat, shtyji njëçikë të zjejë edhe gjella, se mamka do vejë në pazar, pa do të kthehem pak edhe te xhaxha Karafili, se është teze Hasua sëmurë, ta shoh njëçikë. Prandaj do të vnohem ca.

— Mirë, mirë, — i thashë, — mos ki merak tij maima.

— Shiko, — më tërhoqi vëmëndjen nëna, — portën e oborrit mos e hap. Le të trokasın sa të duan. Unë po e kyç atë e po e marr çelësin me vete.

Si iku nëna, mora «Historinë e Skënderbeut» të Naim Frashërit dhe po lexoja me zë të lartë pranë vatrës, duke i ndarë ato fjalët rrrokje më rrrokje, ashtu siç mund të lexojë një nxënës i klassës së tretë të fillores, siç isha unë atëhere:

*Kru-jë, o qy-tet i be-ku-ar,  
Pri-te, pri-te Skën-der-benë*

Ky libër më kishte têrhequr shumë. Babaj, sa herë që ishte i lirë, e merrte ndër duar dhe e lexonte herë me zë të lartë, kur i lutesha ta dëgjoja, herë me vete. Kështu bënин edhe tim vellezër. Kur gjeja rast, si tanë, e merrja dhe i lexoja edhe vetë ato copa që më kishin pëlqyer më tepër. Isha kredhur i téri në leximin tim e me fantazinë time shikoja kështjellën e Krujës mbushur me ushtarët e Skënderbeut tek vinin rrëth me mburoja çeliku e të veshur gjithë në hekur. Skënderbenë e shihja hipur në kalë, duke vringëlluar shpatën në ajër, e tek ja merrte mjekrën e madhe era. Flamuri ynë më bëhej tek valonte i ngritur në vendin më të lartë të kështjellës, palët e tij çpaloseshin madhërishëm e shqiponja sikur fluturonte.

Në këtë kohë «trak» u hap dera. Një fytyrë e panjohur m'u qfaq në fund të dhomës. Përplasa librin në plloçat e vatrës. Këceva menjëherë përpjetë, sikur të më kishte çuar më këmbë një sustë e fuqishme, maçoku që po më flinte në prehërgati sa s'ra në prush dhe mbeta për pak çaste si i shastisur, më këmbë pas oxhakut. Fytyra e panjohur ka vënë buzën në gaz dhe duket sikur mendohet: të hedhë hapa përrpara apo jo. Njëfarë pendimi duket në sytë e tij dhe stepet.

E mblodha veten shpejt-shpejt dhe e pyeta:

— Cili jeni juve? Hajdut?! Shkoni se do t'i thérres babit! Do t'u thérres fqinjëve!

— Jo! jo! jo! — m'u lut i panjohuri e u afrua.

— Nuk e di ti që unë jam këtu?! Nuk të kanë thënë babaj, mamaja? Nuk e di ti që unë jam një shoku i Hiqmetit e i Skënderit e që rrë këtu tek ju?

Mendohem me vete: Ç'është ky mik që ndejtka tek ne e unë s'paskam ditur gjë? Ç'është ky shok i Skënderit e i Hiqmetit? Zëmra më rrihte fort.

Kushedi si qeshë bërë në fytyrë.

I panjohuri më pa me sy të trëmbur.

— Oh, — ja bëri me keqardhje të thallë, dhe shpejt e shpejt mbushi gotën me ujë e më urdhëroi me të butë:

— Na, pije.

Nuk e dija pse ma dha atë gotë, po unë bëra siç më urdhëroi. E piva të gjithë.

U ulëm të dy në minder. I panjohuri po më fërkonte kokën e krahët duke folur më vete i penduar që të dëgjoja unë:

— Sa gabim bëra! Sa gabim!

Pastaj më pyeti i habitur:

— Po si s'e paske ditur ti? Si s'të paskan thënë?

Në këto kështu, ndjeva këmbët e mamasë në koridor. E njoha pa e parë që ishte ajo. Atëhere më shkriu gjaku e m'u la fytyra. «Po qe se është ndonjë kusar, thashë me vete, le të na vjedhë, po deshi. Tani ra në grackë!» Por i panjohuri nuk po turbullohej fare.

Hyri nëna me zimbilin në dorë. Sa hapi derën, thirri e habitur:

— Çeço! të keqen nëna! Si ke ardhur këtu?!

I panjohuri qeshi me keqardhje:

— Le që erdha, se po mbërdhija, zjarr s'kishë e qomyri qe mbaruar, po gabimi më i madh qe se na u trëmb Gimi. Pale, po më quajti edhe kusar. Nuk e paska ditur Gimi?

— Si ta dijë Gimi, mor bir! — foli nëna me ton qortonjës. — Si ta dijë Gimi!

U preka thellë që diçka ndodhët në shtëpinë tonë e mua s'kishin besim të ma tregonin. Kurse i panjohuri me emrin Çeço më hyri në zemër kur i tha nënës:

— Le ta dijë, le ta dijë. Ky është trim i vogël e nuk tregon.

Nëna, duke ardhur rreth, fliste si me vete, por me qëllim që ta dëgjonte Çeçua:

— Ju të rinxjtë jini të rrëmbyer. «I riu si veriu», mirë thonë.

Çeçua e dëgjonte me buzën në gaz dhe më pyeti:

— Ç'po lexoje ashtu?

— Historinë e Skënderbeut.

— E mirë është? Të pëlqen?

— Më pëlqen shumë.

Tani po flisja me të me zë të çelur. E mora me mënd se ai do t'ishte ndonjë nga ata trimat, që i vrishnin spiunët ditën më drekë, mu në mes të pazarit, e nuk i gjente gjë, se bëheshin erë e s'dukeshin».

Shpresa, deri këtu, e lexoi hartimin pa ndonjë interes të madh, vetëm si për të kaluar kohën. Por tani diç iu zgjua në mëndje e në zemër. Vazhdoi më poshtë:

«Ti, do të bëhesh trim si Skënderbeu? — më pyeti Çeçua.

— Do të bëhem.

— E do atdhenë si Skënderbeu?

— E dua, si nuk e dua!

— Dhe do të luftosh?! — më pyeti Çeçua me një zë burrëror, duke rrudhur ato vetullat e bukura. — Do të luftosh si Skënderbeu?

— Do të luftoj, pos! — iu përgjegja edhe unë serioz e i rashë gjoksit me grusht, si për t'i treguar se isha gati që n'atë çast.

Nëna kishte një copë herë që po dëgjonte bisedën tonë atje në fund të shtëpisë, duke ndejnur më këmbë pranë dollapit të ushqimeve me

mjerin kanat të hapur, e kthyer me fytyrë nga ne.

— E dëgjon? — e pyeti Çeçua nënën, dhe hoqi bustinën nga koka e ma vuri mua. — Shikoje partizanin e vogël.

Nëna u duk sikur u zbut. E pashë se i erdhi mirë për përgjigjet që i dhashë Çeços.

— E dëgjoj, e dëgjoj, — iu përgjegj atij. — Po luftën s'e bëjnë kalamajtë.

— Pse?! Edhe këta do të na ndihmojnë.

— Pa rri aty. Mos më merr më qafë djalin. Ku di ai! Vete nesër në shkollë, dhe...

— Joooo! — u kanos Çeçua, e më vështroi me sy pyetës.

U mundova të marr qëndrim burri, serioz e të dukem trim.

— Kurre! — i thashë shkurt, sikur të bëja betimin më të madh.

Që atë ditë u bëmë miq të ngushtë me Çeçon, partizanin ilegal që u strehua tek ne për muaj me radhë. Ashtu sikundër nuk e pata marrë vesh se nga pat hyrë natën e parë që pat ardhur tek ne, nga porta e madhe e oborrit apo nga deriçka që kishim prapa shtëpisë e që të nxirrte në baçe e pastaj në ca rrugë të ngushta, ashtu nuk e merrja vesh nga delte e nga hynte edhe kur mungonte apo kur vinte prapë.

Ai qe i ri, shumë i ri. Kish një fytyrë të mbushur, të bardhë. Qimen e kish të zezë sterrë e të ashpër. Sa hije i kishin ato mustaqet e holla të zeza, n'atë fytyrë aqë të hijshme e të qeshur! Ish i shkathët e me sy të mprehtë, sy që të ngjallnin besimin se asgjë nuk iu shpëtonte. E krahasoja me ata dragojt që luftonin natën me kuçedrat, sipas përrallave që më pat treguar nëna. Kur merrja vesh për aksionet që bëheshin, mundohesha ta shihja me fantazinë time tek ja shkrehte në

lule të ballit fashistit atë revolen me dhjetë fyshekë, që nuk e hijte nga beli, duke i thënë: «Na, fashist, se këtë doni ju!» dhe pastaj, si e linte shtrirë pa frysme përdhe, fluturonte si me krahë.

E pyesja kur bëheshin aksione:

— Çeço, ti e dogje fashon?

— Shshsh, — ma bënte. — Shokët e dogjën.

Partizanët.

Kur ishte në shtëpi e shihja ashtu siç që. Por kur mungonte e shihja me sytë e mëndjes krejt të ndryshuar. Po të ishte plak do ta krahasoja me Skënderbenë, do t'i vija edhe mjekrën e bardhë e do ta shikoja të hipur në kalë të rrethuar nga qindra armiq dhe ai, me shpatën e tij, grin e korr kokat e armiqve sa djathtas, majtas, prapa e përrpara. Mirëpo ai nuk ishte plak. Prandaj e merrja me mënd herë ashtu shtatvigan, që kur e shihnin armiqtë ua mbathnin këmbëve, dhe ai tak hidhte dorën e kapte atë që duhej e ja numuronte dhjetëshen në gojë, herë tek bëhej i padukshëm e hynte gjer në zyrën e prefektit, i fuste ca kamxhikë të mirë dhe i linte traktin përrpara në tryezë ta lexonte.

Çeçua m'u bë kaq i dashur, sa kur mungonte, më dukej shtëpia akull. Vija rreth si i shastisur e më ngjante sikur nuk ishim të sigurtë nga fashistët po të mos ishte ai brënda. Unë e merrja me mend se ai natën nuk flinte, po rrinte roje te porta e oborrit, duke e mbuluar të gjithë portën me shpatullat e tij të gjëra dhe armiqtë, që pesëqind metra larg, e shihnin e tulateshin duke u hequr brinjazi e zvarrë si krimba të zez rëzë mureve, pa e kthyer kokën pas. Pastaj m'u bë i dashur, sepse ai, sapo më pa, më pagëzoi «trim e partizan të vogël». Dhe jo vetëm kaq. Edhe unë doja atëhershë

të tregoja trimërinë time. Po njerëzit e shtëpisë s'kishin besim tek unë. Çeçua, përkundrazi, kishte shumë besim. Ai më jepte letra t'i çoja nëpër baza të tjera dhe më mësonte, si do të bëja po të diktoja ndonjë spiun. Kur çoja letrat, ma lidhët këmbën me fashio të bardhë, gjoja se kisha ndonjë plagë a të vrarë, kurse atje kisha letra, dhe shkoja sa në një vend në një tjetër. Duke shkuar rrugës mendohesha: «po të më kapin e të më kontrollojnë, do të bëj sikur qaj. Por jo, trimat nuk qajnë. Pse, do të qante Çeçua? Kurrë! Po si të bëj? do t'i shikoj me inat fashistët e do t'u them: «Mos më trazoni, se më lëndoni plagët». Kështu që, kur t'i tregoj Çeços, ai të më dëgjojë me gojë hapur...» Aty doja të më dilte ndonjë armik të më kontrollonte, që të kisha rast t'i tregoj Çeços se isha më i zoti akoma, aty kisha frikë. Sido që qe, po Çeçua më besonte mjaft gjëra e unë e kujtoja veten për të madh».

Drita po vinte rreth të bëhej gati. Ajo e kishte marrë ngadalë, se u pa puna që do të shkonin drejt e në kinema, nuk do të bënин shëtitje. Shpresa, e zbetë në fytyrë, me një të dridhur të lehtë të buzëve, duarve e të tërë trupit, vazhdonte tanë të lexonte hartimin dhe, nëpër faqet e defterit të maturantit, shihte fytyrën e Çeços ashtu të gjallë, siç e pat njohur e sikur i flisnin për shumë gjëra ata sytë e bukur e të zez të tij. Shihte pastaj male, pyje, rripa, gërxhe, shpella, fusha... aty të mbulluara me borë, aty të veshura gjithë në blerim. Kollona partizanësh i parakalonin përpëra syve tek marshonin ditën, natën, në shi, në borë, në pisk të vapës... Shihte këmbë të zbathura nëpër borë, që ku shkelnin, mbusheshin gjurmët me gjak; dhe mbi të gjitha këto tërë faqen e shkruar të defterit.

të Agim Çelës, me atë shkrim të bukur, e mbushtetë  
fytyra buzëgaz e Çeços.

Maturanti shkruante më poshtë:

«Ditën e parë që e njoha Çeçon (emri i vërtetë  
i të cilët ishte Astrit, e këtë e mësova vetëm kur  
doli në mal), kur më vuri bustinën e tij në kokë  
e më pagëzoi «partizan i vogël», atëherë duke iu  
gëzuar bustinës së tij, i pashë në të një yll të kuq  
të qëndisur me rruaza dhe iu luta që të ma falte  
mua atë yll. Po ai nguronte. Nëna më qértoi:

— Mos ja merr, se ja ka bërë nusja dhe e ka  
kujtim prej saj.

E pyeta Çeçon:

— Ke nuse vërtet?

Tundi kokën plot hijeshi për të më thënë  
«kam». Edhe tani e kam përpara syve si i ndriti  
fytyra nga një gëzim i brendshëm që ndjeu. E  
besova që më tha të vërtetën. I vogli t'i ble shpejt  
ç'ke në zemër. Ai ka shumë intuitë.

— Ku e ke? — i thashë.

— Kur të mbarojë lufta do të ta sjell. Do të  
rrimë të dy me atë, ja këtu në këtë dhomë, e do të  
të them:

— Ja, Gimi, nusja ime.

M'u duk sikur e pashë n'atë çast ashtu si më  
tha ai: krah për krah me nusen e tij në mes të  
shtëpisë tek më thosh: «Ja Gimi, nusja ime», e u  
gëzova si para një fakti të kryer që në atë çast. E  
pushtova e i premtova:

— Mirë, meqënëse e ke kujtim nga nusja,  
nuk po ta dua tani yllin. Po kur të mbarojë lufta  
ama, e kur të martohesh me të, do ma japësh, ë?  
do ma japësh?

— Medoemos! medoemos! pa tjetër.

— Nëm dorën.

Dhe kështu e lidhëm me besa besë, se ylli i

bukur me rruaza i Çeços, kur të mbaronte lufta, do t'ishte imi».

Kur pat arritur këtu, Shpresa nuk e mbajti dot ngashërimin. Lotët i shkonin çurk pa u ndjerrë. Faqet e defterit të maturantit u lerosën nga boja që shkrinë lotët e saj të nxeh të. Përmes lotëve Shpresa shihte Çeçon, luftën, përpjekjet; ndjente gjëmimin e pushkëve, bombave, mitrolozave, topave, makinave, autoblindave, tankeve... dhe prapë shihte fytyrën e Çeços. Qante me dënesë dhe supet i uleshin e i ngriheshin vazhdimisht. Drita, në dhomën tjetër, e kënaqur që i gjeti një punë shoqes me se të merrej për të mos u mërzitur, po hekuroste bluzën. Dhe për pak minuta do t'ishte gati të delnin.

«Vinin shumë shokë e shoqe për të takuar Çeçon, — shkruante maturanti. — Çeçua nuk ma pat treguar të fejuarën e tij, nusen e tij, atë që i pat rrëmbyer zemrën. Por, unë, midis shoqeve që vinin dhe e takonin për të marrë udhëzime, përmbledhje e punë të tjera, ja pata vënë syrin një shoqeje me një fund të zi e bluzë të kuqe të mbyllur në grykë. Ajo kish një trup të bukur, shtat mesatar, si dhe Çeçua, e hajthme, pak brune, flokët i kish gështenjë të thellë e të shtruar. Sa thjeshtë vishej, aqë e bukur ishte.

— Hë, — thoshja me vete, — këtë ka zgjedhur Çeçua për nuse. Kjo është nusja e tij.

Dhe po të kishte zgjedhur tjetër, do të më vinte keq, sepse edhe atë shoqen e donja shumë. Kur vinte tek ne, ajo më gjëzonte në kokë, dhe më pyeste me zë të ulët që në oborr:

— Aty është Çeçua?

Sa herë pata vënë re t'i shkëlqenin sytë kur i thosha: «Këtu është.» Dhe pa e zgjatur, lija lodrat

e mia në oborr, i bija përpara vajzës dhe shkoja e gricja me thonj te dera e Çeços, se kjo qe parulla për të marrë vesh ai se isha unë që e kërkoja.

Po edhe sa herë e pata vënë re atë vajzë si mbetej një çast e dëshpëruar në mes të oborrit, kur i përgjigjesha:

— Jo, Çeçua ka ikur mbrëmë natën.

Nga fundi i vitit 1943 e në fillim të vitit 1944 Çeçua, tim vellezër, e shumë nga ata ilegalë që hynin e delnin tek ne, shkuan një natë e s'u panë më. Ata dualën partizanë në male e u bashkuan me çetat, batalionet e brigadat tonë. Edhe Shqipen, (kështu e thërrisin atë shoqen që unë me mëndjen time e kisha caktuar si nusen e Çeços e mezi prisja ditën të vinte mbarimi i luftës për ta shikuar krah për krah me Çeçon në mes të odës) nuk e pashë më. Edhe ajo kishte shkuar partizane në mal.

Kur u çlirua qyteti ynë dhe partizanët hynë, duke mbushur rrugët tejpërtëj, unë prita të na vinte Çeçua që në mëngjez. Po Çeçua nuk erdhi. Dolla nëpër rrugët e qytetit dhe e kërkova. Bridhja si ato konkat që vinë nga fshati në qytet, humbasin të zotin dhe e kërkojnë duke i shkuar pas kujdo që u ngjan si i zoti. I ndiqja nga pas partizanët. Më dukej ndonjeri nga shpatulat si Çeçua. Nxitoja, i delja përpara, e shihja që s'ishte ai e i qepesha pas tjetrit më tej. Po atë s'e gjeta, s'e pashë. Pashë mijëra partizanë me yje në ballë si Çeçua, me revole në brez, me bomba ngjeshur si edhe Çeçua, po Çeçon tim, partizanin tim, nuk e pashë. Brodha sa m'u muar fryma dhe vajta në shtëpi. U pështeta, i lodhur e i këputur, në minderin e dhomës së zjarrit, n'atë vënd ku qemë ulur të dy me Çeçon, krah për krah, ditën e parë që e njo ha, dhe i thashë nënës:

— Nuk e gjeta dot Çeçon moj mama! Pse s'po vjen? Pse po vonohet?

Ajo më foli me sytë përdhe e me zë të mekur, sa mezi e dëgjova.

— Nuk e gjete?

Dhe siç ishte atje te dollapi i ushqimeve, duke kërkuar diçka, e la dollapin hapur e iku pa u kthyer nga unë ta shihja në fytyrë.

Më pikoi në zemër e m'u rëqeth trupi.

— Mama! Mama! — i thirra pa lojtur nga vëndi. Po ajo nuk m'u përgjigj. Gjunjët dhe duart sa vinte më dridheshin më shumë. Edhe doja të ngrihesha, të gjeja nënën e ta pyesja, edhe s'doja. Po pse? C'parandjenja kisha? Ah! Mos kurrë! As zemra ma qaste as goja ma thoshte të ligën.

Pa shkuar as dy tri minuta, u kthyte nëna bashkë me Shqipën të veshur partizane, me automatik në krahë...

Këceva më këmbë si i çmëndur nga gjëzimi e iu hodha në qafë. Ajo më pushtoi aq e gjuar sa as motra nuk do më kishte puthur e pushtuar aqë fort. Më lëshoi mua e u pushtuan përsëri me nënën duke qëndruar të dyja në krahët e shoshoqes në mes të dhomës. Ato s'po shqiteshin. Mua nuk më durohej. E zura Shqipën nga cepi i xhaketës ushtarake, e shkunda fort dhe i thirra:

— Shqipe! Shqipe! Po Çeçua? Po Çeçua, ku është?

Siç ishin akoma pushtuar, nëna i tha ngadalë në vesh:

— Gimit nuk i kemi treguar. Ai s'di gjë.

Por unë, që përgjoja i mallëngjyer, jo ç'dilte nga buzët, po edhe ç'thoshin sytë, i dëgjova qartë.

Thirra duke qarë dhe e tërroqë akoma më fort partizanen për xhakete:

— Shqipe! Çeçua, Shqipe, Çeçua ku është?!  
Pse s'më tregoni?!

Ajo, pa u shqitur nga krahët e nënës, u lëshua me trup fare, vari kokën, pështeti faqen në sup të nënës, më vështroi me lotë në sy e më tha:

— Çeçua u vra. Ka tre muaj që është vrarë.

Nëna e Shpresa u ulën të dyja në minder. Ajo i vuri kckën nënës në gjoks dhe shihja përmes lotëve të mi si ngriheshin e uleshin supet e saj. Nënës i shkonin lotë çurk dhe i thosh Shqipes, duke i lëmuar flokët e ballin:

— Hesht, bijë, hesht! Kështu e ka lufta. Pa këto, s'mund të vinte kjo ditë.

Pashë Shqipen që nga pas, siç qe përbys në prehër të nënës, që futi dorën në gji e pastaj e nxori, u ngrit pak gjithë duke ngashëryer, e zgjati dorën nga unë e më tha:

— Gimi, na, merre...

Ishte bustina e Çeços.

Atëhere nuk qava, por ulurita: «Dua Çeçon!» dhe rashë përbys në mes të dhomës».

Drita qe bërë gati dhe, duke kërcyer si ndonjë balerinë, erdhi gjithë e qeshur e e gëzuar në dhomën ku qe Shpresa. Në fillim, pa e parë fare shqegen se ç'po bënte, thirri:

— Shikomë Shpresa, a nuk dukem si flutur!

— e u rrotullua në mes të dhomës dy a tri herë. Zhuponi gufoi në erë.

Po Shpresa kish rënë përbys në kanape mbi faqen e fundit të hartimit të lerosur, që nuk lexohej gati fare tanë, dhe i kërcenin supet e ijët si t'i kishte zënë njeri frymën.

Kur e vuri re, Drita ngriu në vend me krahët hapur, si t'ish përpara diçkaje që e tmeronte.

— Shpresa! Shpresa! Ç'ke kështu? Shpresa!

I mori duart, e ngriti ndenjur dhe pa se ç'ndodhje me të.

— Ç'të ka ngjarë, moj? folë! Të lajmëroj për ndonjë doktor?

Shpresa shkoi pëllëmbët nëpër faqe. Fshiu lötët. Rreguloi flokët e u ngrit duke u dredhur e tëra.

— Asgjë! Asgjë! — i tha shoqes e u mbajt pas supeve të saj, duke i shkuar krahun në qafë, — Asgjë s'më ka ngjarë, po m'u lëndua një plagë e vjetër...

Asaj i kishte ndodhur gati si Davidit me Anjzen. Ishin rritur bashkë si fqinjë që në vegjeli. Dhe pse i kishin thirrur shoqishoqit vëlla e motër. për një kohë të gjatë nuk kishin guxuar t'i thoshin njeritjetrit «të dua»; gjersa më në fund, një javë para se të vritej Çeçua, kishin shpallur fejesën në mal si partizanë.

## ZË NË FURTUNË

Pas darke ishini mbledhur rrëth zjarrit e po bisedonim. Mbi sobë kishim hedhur ndonjë kile gështenja për të pjekur. Dy pjata të mëdha i patëm mbushur me mollë, fiq e arra. Atë natë na kishte ardhur mysafir Shefkiu, një kushëriri ynë nga nëna, pedagog në gjimnaz. Guzhina qe ngrohur, qe bërë valë. Po jashtë ishte shumë ftohtë. Kishte një javë që temperatura kish rënë tetë-nëndë gradë nën zero, si rrallë herë qëllon të bjerë kaqë shumë në Tiranë.

— Të jesh përjashta në këtë të ftohtë, ngrin sikur loz, — tha im vëlla, Gjyshua, që ndjek sivjet klasën e gjashtë.

Motra, Shega, që ndiqte klasën e katërt, u droth sikur ta kishin zënë ethe dridhme:

— Ubububu, ja bëri ajo, — unë nuk duroj dot as një orë dhe ngrij në vënd.

Këtë bisedë e hapi thëllimi që frynte e ulurinte përjashta, dhe sikush nga ne tregoi si kish mardhur një herë, si kish dëgjuar për një njeri që qe gjendur i ngriрë në mal pas dy tre muajsh, mbasi pat shkrirë dëbora. Pastaj dualën pyetje të ndryshme: gjersa e duron të ftohitit trupi i njeriut? Kur ngrin njeriu e kupton apo s'e kuption?

Ç'duhet bërë për të mos ngrirë? A mund të shpëtohet i ngriri dhe si mund të shpëtohet?...

Kishim filluar të hanim frutat dhe u duk sikur u mbyll kjo bisedë, kur Shefkiu, që gjer ahore s'pat folur, po vetëm dëgjonte, tha ashtu si për së koti:

- Unë kam parë njerëz të ngrirë.
- Vërtet?! — thirrëm të gjithë me një zë.
- Kur i ke parë? — Dhe e vështruam në sy sikur t'i thoshim: — E po folë, pse s'na tregon?!

Dhe ai atë natë na kallzoi këtë ngjarje që e kishte jetuar vetë:

«Isha dhjetë vjeç. Atëhere, siç e dini, banonim në fshat, në Skrapar. Shtëpinë e kishim ndanë fshatit, pak si më të shkëputur, majë një bregthi. Nga lindja kishim selishtat, kurse nga perëndimi, vëndi ishte shtuf e shumë i pjerët. Në fund të këtij shtufit kishim prapë një arë e, pak më tej, qe një përrua, i cili vinte që sipër malit. Rreth e qark shtëpinë e kishim të thurur me oborr, ku qenë ca pemë-mëna, qershi, ftonj e ca hardhi.

Qe dimër, ja, si në këto kohë, janari i vitit 1943. Andej nga ne bie dëborë. E sidomos në fshatin tonë dëbora fillon në vjeshtë e ikën në maj, se jemi mu rrëzë malit, kaqë sa, kur ngre sytë e sheh përpjetë, të duket për një çast sikur do të bjerë mali e do të të zërë ndënë të. Atë mot bëri dimër shumë. Pleq shtatëdhjetë-tetëdhjetë vjeçarë thoshin se s'mbanin mënd kurrë të kishte rënë ndonjë herë poshtë në fshat aqë dëborë. Çezmën e kishim në fund të oborrit, por edhe gjer atje, rrugën e hapnim çdo mëngjez duke qëruar dëborën me lopata. Gjënë e gjallë e nxirnim jashtë njëçikë sa për t'iu dhënë ujë e natë e ditë i mbanim brënda. Nga një fshat në tjetrin njerëzia luanin

shumë rrallë, vetëm kush kishte ndonjë hall buke, ose korierët, që merrnin e binin ndonjë lajm prej partizanëve.

Një natë, ishte ora nj'a shtatë — qemë mble-dhur pas zjarrit e po ngroheshim. Sapo kishim ngritur sofrën dhe nëna na vuri një sahan me arra përpara e tre ftonj. Babai ishte në njërin kënd, në këndin tjetër qe xhaxhai, pastaj vinte e shoqja e xhaxhait, çupa e tij, unë me tim vëlla, Feritin, — ai qe ahene pesë vjeç m'i madh se unë — kurse vëllai im i madh dhe dy djemt e xhaxhait ishin partizanë në bataljonin Tomorri.

Nëna sa kishte filluar të çante arrat dhe babaj nxori çarkjen të na ndante ftonjtë. Nëna çante një arrë e pastaj mbante vesh. Çante tjetrën e prapë mbante vesh.

— E ç'mban vesh ashtu?! — e pyeti babai me zërin e tij të vrazhët.

— Mor burrë, sikur ndjej një zë! — i tha ajo.

— E ç'është ky zë! e qértoi ai. — Çaj arrat aty, se ty kështu të avitet nganjëherë! Kush del jashtë në këtë qamet? Rri aty, se ashtu të bëjnë veshët ty!

Babai i foli kështu me inat, sepse nëna, nga që kishim tre djem partizanë, gjithmonë ishte me gjak të ngrirë e sa herë që na thërriste njeri që jashtë, asaj i dukej sikur sillnin mandatën e ndonjërit prej tyre. Prandaj babai nuk ja ushqente kurrë fjalën.

— Jo, mor burrë jo, — i tha nëna dhe mbajti vesh përsëri, — nuk më bëjnë veshët mua, po se kush thërrret! Kur isha matanë, tek po merrja ftonjtë e arrat, e shquajta mirë një zë që thërriste.

Megjithqë babai nuk e bëri veten, dashur padashur, në shtëpi u bë qetësi e plotë. Stoçeni vër-

shëllente përjashta e ulurinte mbi çati e nëpër hatulla sa të ngjethet mishtë. Babai mbajti vesh një copë herë nga dritarja e na foli:

— S'ka njeri, jo!

Po në zërin e tij kish më shumë dyshim se bindje për atë që tha. Pastaj na ndau nga dy thela për secilin. Muarrëm edhe arrë e po përtypeshim, por të gjithëve na bënин veshët sikur dëgjoni zë njeriu. Përtypeshim e mbanim frymën.

— Ja! — thirri nëna, dhe e lëshoi thelën e ftoit, — e dëgjuat?! Zë njeriu!

Ajo u verdh e u bë dyllë. Ne u trëmbëm e po vështronim nga dera me sytë të shqyer sikur prisnim fashistët të na hypnin mbi çati në çast.

— Hej, të mori dreqi, të mori, me këto fanep-sjet, e tua! — e mallkoi baba nënën dhe u ngrit shkoi në konakun tjetër, hapi penxheren e mbajti vesh. Ne prisnim me ankth e të turbulluar. Xha-xhai më mori mua pranë gjurit, më fërkoi kokën, e më tha:

— Mos ki frikë, ti djal' i xhaxhait, se s'ka gjë.

Babai erdhi duke çfryrë, u ul në këndin e tha: prerë:

— S'ka gjë, jo!

— Filluam të hanim, por sepse na u lith e mezi kapërxeheshim. Megjithëse babai tha «s'ka gjë», edhe ai edhe ne të gjithë veshët i mbanim përpjetë. Mua më dukej sikur dëgjoja jo një zë, po qindra zëra. Veçse kisha frikë të thosha.

— Zë or burrë, zë! — thirri nëna me sy të çakarritur e u ngrit më këmbë si e lojtur mënç.

Unë po dridhesha i téri. Po edhe të tjerëve

po iu dridhej zëmra nga angushtia. Mbetëm me gojën plot. Babai u ngrit edhe ai, e mbërtheu nënë për të dy krahët e iu kanos duke e tundur:

— Mos u çmende?! Mblidh moj mendjen!

— Në jini burra, dilni mbani vesh përjashta, se ka një zë që thërret! — u lut nëna.

Xhaxhai brofi në këmbë, mori maliherin. Im atë e pati marrë më përpara dhe dualën të dy. Feriti mori sëpatën në fund të shtëpisë dhe një bombë e fluturoi edhe ai.

— O zot, ç'do të jetë! — rrihej e përpinqej nëna duke ardhur rrëth shtëpisë me duar në kokë. E shoqja e xhaxhait ish trime grua, si ndonjë burrë.

— Ç'ke që cirresh kështu?! — i foli nënës. — Mblidh moj mendë!

— Djemtë! Djemtë! — përsëriste nëna me të qara.

— Unë kam dy, i kam edhe më të vegjël se yti, e s'kam gajle, ti një ke andej, — i foli ajo.

Duke përfituar nga habija e mëmës, edhe unë dolla përjashta dhe qëndrova te muri oborrit kukishin qëndruar babai, xhaxhai e Feriti:

— Pa thirrë ti njëherë, — i tha babai xhaxhait.

E ai thirri në drejtim të pérroit, gurgullima e thellë e mbytur e të cilit mezi vinte në veshët tanë. Xhaxhai megjithëse ka një zë të trashë-kumbonjës, që dëgjohet një orë larg, atë natë u duk sikur nuk u përhap as dhjetë metra larg.

— Eshtë bela, — foli im atë me zemërim, — se në dëborët nuk ikën as zëri.

Mbajtën vesh e iu duk se me të vërtetë dikush kërkonte ndihmë.

— Zbraze një herë!

Xhaxhai e zbrazi maliherin, po edhe pushka

u duk sikur ra në pus. Përgjigje me pushkë nuk muarrëm, por zëri që pat thirrur u duk sikur u ndje përsëri. Me të rënë pushka, kushërinjtë tanë dualën.

— C'është kështu, o Sefer?! — e Pyetnë babanë.

— Mor po një zë na duket sikur vjen që përtej prroit, po nuk e dimë, a na bëjnë veshët a vërtet ka njeri. Sidoqoftë s'do të flemë dot rehat, po o burra të vemi gjer atje, — foli im atë me zë të vendosur e bëri tutje në drejtim të prroit.

— E çahet kjo borë, a derëzi?

«E çajmë dot», — s'e çajmë dot, u bë muhabet një çast e më në fund u nisën babai, xaxhai, vëllai edhe pesë kushërinj, duke mbajtur piشا të ndezura ndër duar e gunat hedhur. Nëna, e shoqja e xhaxhait, qupat dhe unë pritnim të hesh-tur rrëzë murit të oborrit mbuluar me një velenxë të madhe. Dëbora binte pa pushim e i kish mbuluar pemët fare. Kishim një arrë para shtëpive, ajo dukej si një këpurdhë vigane dhe mezi shqu-hej përmes perdes së flokëve të shpeshtë të dëborës. Babai e të tjerët ecnin e thërrisin: «A ka njeri aty, ore?» Po tani, që përtej përroit më s'ndi-hej zë.

— I more më qafë meshkujt në këtë qamet!  
— e qërtoi nënën e shoqja e xhaxhait.

— Moj po unë e dëgjova me këta veshë, — po tani, kushedi, do ketë ngrirë, — iu përgjegj nëna duke u dredhur e tëra si purtekë.

Nga shtëpitë tona gjer përtej përroit, po të mos kishte dëborë, vije për dy minuta me të bre-dhur, mirëpo ata u vonuan një cerek ore. Kish rënë dëborë gjer në brez e mezi çahet. Stoçeni të verbonte sytë. Kur vanë përtej përroit, qëndruan ca. Pastaj u kthyen përsëri lart. Në t'ardhur u vo-

nuan akoma më shumë. U muar vesh se dikush do të kishte ngrirë. Hymë brënda. Më shumë dridheshim nga frika, se nga të ftohtit.

Kur erdhën burrat, prunë në krah dy veta të ngrirë.

Ç'llahtar! I vunë të ngrirët në konakun e zjarrit. Nuk dihej në kishin vdekur apo ishin gjallë akoma. Babai ishte njeri i vojtur dhe dintë shumë gjëra. Mori një pasqyrë e ua vuri te buzët të ngrirëve, një herë njerit, pastaj tjetrit. E bëri këtë provë disa herë e mandej u ngrit me duart në ijet dhe tha, duke marrë frymë thellë e i lehtësuar: «Rrojnë që të dy. Pasqyra dërsiu». Pastaj iu përvesh punës pér shpëtimin e tyre. Atë natë gjithë njerëzit e shtëpisë u gdhinë. Edhe unë ndeja gjer vonë duke ardhur rreth nëpër këmbët e tyre e më luftonte zemrë duke lutar të shpëtonin dy të ngrirët. Në gjumë, më bëhej sikur ngriheshin dy të ngrirët në këmbë, ashtu kallëp siç kishin mbetur në dëborë, me sytë si xham, e sikur binin mbi mua. Kur u zgjova në mëngjez shkova fshehurazi në konakun e tyre dhe kur dëgjova se kishin shpëtar, iu hodha mëmës në qafë, e putha, pa ditur as vetë përsë. Pas një jave, të ngrirët u çuan më këmbë pa asnjë cen në trup. Po mua, edhe sot, kur më kujtohet ajo natë, tha Shefiku në fund të kallëzimit të tij, — se si më vjen, më rrëqethet trupi dhe tmerohem.»

— Po mirë, — e pyeti ime motëri si më kureshtare nga të gjithë, — cilët ishin ata të dy që u gjetën të ngrirë?

— Njeri ishte një partizan i grupit të Skraparit, — shpjegoi ai, — tjetri ishte partizan i komandës së vendit. Partizani i grupit të Skraparit, para ca kohësh, ishte plagosur në dorën e djathtë,

në një përpjekje me fashistët. Dora i qe dërmuar fare e ja kishin prerë. Shtabi i qarkut, meqënëse ai kishte mbaruar shkollën Normale të Elbasanit, si dolli nga spitali, e kishte ngarkuar të punonte në terren dhe të hapte shkollën në fshatin tonë. Ai hapi shkollën tonë edhe shumë të tjera në mjaft fshatra. Paradite na mësonte ne dhe pas-dite shkonte sa në një fshat në tjetrin: bënte mbledhje, ndihmonte mësonjësit, që i kish caktuar ai vetë, e në mëngjez na vinte përsëri në klasë. Bazën e kishte në shtëpinë tonë e nënës i thosh gjithmonë «ti ma ke shpëtuar jetën» dhe nuk i thërriste në emër, po «nënë» si edhe unë.

U bë një copë herë qetësi, të gjithë po mendoheshin. Murrani përjashta vërvhelleu e na u duk sikur u përplas diçka pas xhamave të dritareve duke dashur të hynte brenda me forcë.

Dimri çfrynte me tërë furinë e tij të egër.

Motra thirri duke u dredhur:

— U bubububu sa frikë më vjen! — dhe u m'blodh shuk pas zjarrit.

Ne të tjerët nuk folëm, por në të vërtetë, me që na erdhi pa pandehur ajo goditje e murlanit, ndjëmë që të gjithë të dridhura në zemër.

## KUR MBUSHET KUPA

Në njerin kënd qe ulur komandanti i batalionit, në tjetrin komisari. Nga ana e djathtë ishin pështetur pas murit dy komandantë kompanish dhe komisari i kompanisë së parë. Asnjeli s'fiste. Në dhomë ishte qetësi. Drutë e dëllinjës, që digjeshin në oxhak, kërcisin herë pas here dhe shpërnda-nin shkëndia në vatër.

Dy partizanë hynë në derë dhe përshëndetën me grusht. Njeri prej tyre, ay m'i gjati, foli:

— E prunë shoku komisar. Ta fusim brenda?  
— Futeni.

Në konakun ku ishte shtabi i batalionit të rinisë së qarkut hyri një burrë dyzet-dyzet e pesë vjeç, me mustaqe të verdha, që kishin zënë t'i thinjeshin, i parruar, veshur me xhaketë e pantallona shajaku të vendit. Si nderoi me dorë, qëndroi në fund të konakut e po priste më këmbë. Dy partizanët i rrinin pas.

— Ulu, — i tha komisari burrit me mustaqe të verdha.

Ai u ul këmbékryq atje ku ish, në fund të konakut.

— Jo, jo aty, — e urdhëroi komisari, — afrohu më lart.

Burri u mbështet mbi të dy duart, u çua si i lodhur e u ngjit më lart, nga mezi i konakut.

— Afroju pranë vatrës. — i tha komandanti i batalionit.

Dy partizanët që e shoqëronin qëndruan në këmbë te dera me malisherët në duar.

Komisari vështroi komandantin në sy e ja bëri me kokë duke i treguar burrin që kishin në mes, sikur t'i thosh: «Pyeteni».

Komandanti e kuptoi dhe iu përgjegj vështrimt të tij me zë:

— Pyeteni ju, shoku komisar.

Të gjithë sa ishin në konak po vështronin burrin me mustaqe të verdha, që rrinte këmbë-kryq pas vatrës me sytë nga zjarri e i menduar.

— Si të quajnë? — e pyeti komisari i batalionit.

— Faik Hyseni.

— Prej nga je?

— Nga komuna e Poroçanit.

— Nga ç'fshat?

— Nga Pëndari.

— Mirë, — vazhdoi komisari, — na trego ç'-ndodhi mbrëmë atje tek ju.

Faiku vuri dorën në ballë qetë qetë, pshëriti thellë, ngriti qylafin, kruajti kokën, e rregulloi prap qylafin e zi dhe filloj:

— Mbrëmë, aty nga ora një e natës...

— Allaturka? — e ndërpreu komisari.

— Po, allaturka, — u përgjegj Faiku dhe vazhdoi: — ishim nja tridhjetë ballista. Kishim bërë një zjarr të madh te një breg e po ngroheshim. Me ne ishte dhe komandanti ballist Hamza Velua. Në këtë kohë vjen që përposh partizani juaj. Ai nuk e dinte se atë breg, që e kishit ju në mëngjerez, ne ua kishim marvë mbasdite e ju ishit térhequr. Ne nuk

e pikasëm fare, veçse kur na u faneps te zjarri. Kujtoi se ishim shokët e tij dhe na përshëndeti me zë të lartë, i gjuar, duke iu marrë fryma e duke gulçuar:

— Vdekje fashizmit, shokë!

Për një çast ngrimë në vend. Vështruam njeri tjetrin të trëmbur.

Hamza Velos i ra cigarja nga dora e zgurdu-lloji sytë. «A u rrëthuam? U rrëthuam!» Por, e mbledhi përnjéherësh. «Liri popullit», iu përgjigj partizanit, i cili qe ulur në bisht pas zjarrit e pongohte duart duke na hedhur një sy të gjithëve. Si nuk pa aasnë të njohur, partizani e kuptoi menjéherë që ne nuk ishim shokët e tij është shpejt e shpejt hoqi automatikun nga krahë. Por nuk arriti ta zbraste. Hamzai ua kish bërë me kokë disave, i kish marrë krahët, dhe ai vetë bashkë me nj'a dhjetë të tjerë i kërcyen përsipër. E carmatosën, e lidhën dhe pastaj shkuam në shtëpitë e para të fshatit, që ishin aty afër.

Partizanët dëgjonin të heshtur e të zymtë. Komandanti i batalionit i pat ngulur sytë në një pikë të pacaktuar në mur e s'i hiqte. Komisari kishte zënë mjekrën me dorë, dukej sikur vështronët nga Faiku, po mendjen kushedi ku e kishte. Faiku heshtëtë dhe për një çast u duk sikur nuk kish për të thënë gjë.

— Pastaj, ç'ndodhi? — pyeti komisari.

— Pastaj, — tha Faiku, duke vështruar gjithnjë nga zjarri e sikur t'i rëndonte mbi shpatulla një turp i madh, — pastaj... e rrähën. — Pushoi një grimë. — E rrähën, e bënë kërmë, ashtu siç e patë edhe vetë. E shanë. E pështynë... I hipën përsipër... I thyen krahun.

— Kush?

— Hamza Velua, ai qeni i tërbuar, pastaj edhe

të tjerët: Ali Buza, Jani Papailia. . . E pyesnin djal-thin e mjerë: «Sa partizanë jini?! — Sa drurë ka pylli», iu përgjigjej. — «Pse thua kështu? Pse s'tregon?» «Sepse juve edhe drurët u duken partizanë. Ç'ju duhet ta dini sa jemi» «Kë kini komandant e komisar?» «Atë, që ju ja kini frikën më shumë! Partinë kemi». «Je në Parti ti, qen?» «Me partinë është i gjithë populli, veç ndyrësirave si juve, veç tradhëtarëve, veç atyre që po vrasin e po djegin popullin. Veç atye që harruan atdhenë, nënën, gruan, motrën e u bënë me fashizmin! — «Dhe duke tundur kokën në shënjë habije, Faiku vazhdoi të fliste: — E rrahën sa s'thuhet. Po shpirti s'dalka kollaj. I binte të fikët, e përmendnin; e rrithnin prapë, prapë i binte të fikët. Eh, i mjerthi djalë, i mjerthi djalë! . . . Hamzaj e paskësh njo-hur edhe më parë atë trim e i ruante inate të vjetra, sepse partizani e kishte demaskuar fshatrave e kishte thënë për të se e priste litari me dhjamë.

— Ti e rrahe? — e pyeti komandanti i batalionit.

Faiku ngriti kokën dhe e vështroi sikur të përmendej nga gjumi.

— Urdhëro?

— Ti e rrahe, po të pyes?

— Unë! Jo.

— Po ç'bëje?

— Rrija në fund të odës me nj'a dy bashkë-fshatarë e me ca të tjerë.

— Nuk të thanë që ta rrithnje edhe ti, kur ladheshin ata të tjerët?

— Më thanë.

— Po ti ç'bëre?

— Mjaftni, — u thaçhë, — mjaftni se është robi i zotit! — dhe s'luajta nga vendi.

— Po ata bashkëfshatarët e tu?

— Edhe ata s'vunë dorë; nuk deshën.

— Tjetër, ç'ke të na thuash?

— Tërë natën e rrahën, tërë natën! Hamza Velua, si piu edhe ca gota, u çmend fare. «Ku e ke litarin me dhjamë të më varësh?!» i çirrej e i bërtiste. Po djalit s'ju trëmb syri. Eh, s'dalka shpirti kollaj, jo! Kur donte edhe tre sahat natë të gdhihej, Hamza Velua u ngrit, erdhi në fund të odës dhe na u drejtua neve: mua edhe dy bashkëfshatarëve të mi: «Ti, ti edhe ti», — na tha ne të treve, duke kërcitur dhëmbët, — ngrehuni, merreni atë këlyshin e Moskës, merrni edhe dyfekët e hajdeni me mua.

E kuptuam se ishte puna për pushkatimin e tij.

Domosdo që nuk do ta linin pa e pushkatuar, por kur e dëgjova që tha ashtu, sepse m'u rrënqeth trupi i gjithë dhe m'u ngrit lesht e kokës përpjete.

Që ditën që na mori me vete me forcë, Hamza Velua, më qe qepur e s'më ndahej. As unë nuk e di pse i kishte shkrepur me mua. Atë ditë që na mori, dogji një palë shtëpi të një fshatarit tonë, që qe me partizanët, dhe më tha: «Merr një krahë bar atje n'atë mullar e veru zjarrë». Jo, — i thashë, — unë nuk e bëj dot!» «Vérua zjarrë!» «Nuk ua vë!» U hëngra me të kështu një copë herë të madhe, sa më në fund urdhëroi nga tre a katër nga ata besnikët që mbante pas. Pesë muaj, sa qesh me të, më erdhi shpirti në majë të hundës, m'u bë shpirti helm e zeher. E kë të vrisja, vëllanë? Kë të digjëja?! Kë, të shkretetoja?! Po Hamzaj më rrinte sqyfter mbi kokë: «Pse s'e ke zbrazur sot?... Merre, there këtë ka!... Véri zjarr kësaj shtëpie!...» Më kish vënë pas edhe një nga ata larot e tij e ai

më qe bërë mortje e dytë. Kushedi sa herë qesh matur t'i fusja një plumb Hamzajt e t'ikja, por... Gjersa më në fund, mbrëmë, nuk e durova dot thikën që më pati vajtur gjer në eshtër dhe thashë me vehte: Për të vdekur kemi, por të paktën të vdes me nder, të mos lë fëmijët me kokë ulur përrpara fshatit, përrpara miqve e shoqërisë. Mendova: Po do të vuajnë kalamajt e mjerë! S'ke ç'i bën, do të vuajnë, do të heqin... po s'do vdesin. Dhe kur të rriten nuk do t'ua rrähën synë bota e t'u thonë: «Ikni, ore, se ju dimë të kujt jini, djemt e tradhëtarit!» Kështu, mbrëmë, e bëra tetë. Kur na shënoi Hamza Velua: «Ti, ti edhe ti», fap, më hypi damari i ballit, një dritë më shkrepri në zemër e thashë me vehte: «Qëroje plehët, Faik, e shpëto nga ky qen!» Kceva vetë i pari, rrëmbeva patickën për gryke, hekuri i saj më ftohu dorën e nxehëtë dhe u thira bashkëfshatarëve të mi, që shënoi Hamza Velua me gisht:

— Ngrehuni, vëllezër!

Ata, them unë, u çuditën, sepse ne vërtet s'biseduam dot gjë me shoqi shoqin, (ku të bisedonim?) por e vërteta është kjo që, si mua edhe atyre s'na bënte zëmra të vrissnim djalthin... Si më panë mua që u ngrita, u ngritën edhe ata.

«Këta, — tha Hamza Velua, për ne, — pa iu drejtuar njeriut, por që foli ta dëgjonin të gjithë, — duan të mos e përgjakin dyfekun me të kuqtë, që të jenë të larë nesër e të thonë: «Jo, ne s'kemi bërë gjë! S'e kemi zbrazur kurrë kundra partizanëve», se i gënjen mendja se do të fitojnë partizanët. S'ma hedhin dot mua, jo!» Pastaj u drejtua nga ne: — Pa hajdeni tani, — na tha, — përgjakni edhe ju ata dyfekë, ta marrim vesh njëherë, jini me ballin apo me partizanët». Të tjerët i urdhëroi:

«ju rrini këtu!» Disa nga shokët tanë po dremisnin vërtet, kurse ca të tjerë u shtinë sikur dremisnin. Vetëm ata larot: Jani, Aliu... hodhën edhe nga një gotë, u sheshuan më mirë dhe ja krisën të qeshurit. I vura krahët djalhit, e ngrita më krahë e i thashë mengadalë: «Ngreu, vëlla». Ai më vështroi në sy e më foli: «Po të erdhi rasti të takosh partizanët, thuaju se Partinë, Atdhenë e shokët nuk i tradhë-tova gjer në çastin e fundit». «Mirë vëlla, mirë», — iu përgjigja me ngadalë.

Nga krahu tjetër erdhi e e zuri Brahimi, kurse Dania ndeji pas. Hamzai po na priste në oborr. Sa dualmë jasht gardhit të oborrit, Hamzai na urdhëroi:

— Lëshojeni zagarin dhe futini dy plumba, hidhjani trutë në erë!

— Zoti komandant, — i them, — ta çojmë më poshtë. Nesër ngrihen gratë, qilimjtë, janë maksunë e trëmben. E çojmë edhe pak më poshtë, i biemë dhe e hedhim më ndonjë rripë. Nuk e zgjati. «Hajde, — tha dhe bëri përpara. Duke shkuar e cimbita Brahimin në krah fort. U ktheva pas, shikova dhe Danen dhe i tunda kokën. A më kuptuan, a s'më-kuptuan, nuk e di. Si eci ca, Hamzai qëndroi në një ledh e na urdhëroi:

— Lëshojeni, dhe hë, bjerini shpejt!

Ne e lëshuam djalthin. Ai ra përmibys. Dhe unë e heq i pari shpejt dyfekun nga krahu, i jap një të shtymë Brahimit, i dal përpara dhe ja pata Hamzajt, siç e kisha në brinjë, mu në rrëzë të veshit. Nuk bëri as hof as hif, u rrotullua njëherë e u përplas përdhe. Brahim me Danen ngrinë më këmbë pa hequr as dyfekët nga krahu.

— Ç'bëre! — më thirri Brahimini.

— Mjaft, u mbush kupa! — them dhe i bie

**Hamzajt edhe katër herë të tjera me radhë.**

— Po tani? ku të vemi? — më pyetën në një gojë Brahimi me Danen. — Do të na ndjekin, na e shove binanë, na le fëmijët udhëve!

— Unë, — u thashë, — po marr partizanin në krahë e po shkoj te partizanët. Juve, në daçi hajdeni me mua, në daçi shkoni në shtëpi. Mos kini merak, se nuk do të na ndjekin. E para: nuk do t'u vejë mendja për një gjë të tillë; e dyta: edhe ta kuptojnë, do ta kuptojnë vonë. Gjersa të gdhihet, ne e kemi zënë vendin. — Dhe s'e zgjata më. I vura shpatullat partizanit, e hodha në krahë e u nisa për nga ju. Sabahu më zuri këtu, siç e dini. Dy shokët e mi nuk erdhën. Se nga ja mbajtën nuk e di. Po doemos do të kenë vajtur në shtëpitë e tyre. — Pastaj Faiku zuri të fliste përsëri me vete si nëpër ëndërr:

— I mjeri djale, rënkonte gjithë rrugës.

Kur u përmend partizani i torturuar, pas njëzet e katër orësh, vërtetoi të gjitha ato që kish thënë Faik Hyseni.

## KOSHERET E BLETEVE

Te lëmi, prapa kasolles së kashtës, nën hien e një dardhe ishin dy koshere me bletë. Këto, Veseli, babai i Bimit, i pati gjetur qysh në pranverë në dy zgërbonja lisi, sipër në mal. Bletët kishin ardhur të mbara. Ato kishin vënë mjaltë të mirë. Një herë në dy javë Veseli vinte i shikonte dhe i thoshte së shoqes me gëzim e duke fërkuar mustaqet:

— Njëzet qillo mjaltë ka çdo koshere, në mos më shumë. Ç'do të bësh me këtë?

— E ç'do të bëj, mor burrë! — i përgjigjëj Nazmija, — nuk i sheh? — dhe i tregonte fëmijët me kokë, — i kemi lakuriq në fill të këmishës. Do veshim fëmijët.

Veseli tundte kokën. Me atë shenjë ai tregon te se ashtu duhej bërë siç thoshte ajo. Dhe disa herë pati shtuar:

— Mirë, moj grua, po edhe ti ke mbetur pa fustan.

— Po ta zemë ashtu, edhe ty të janë bërë shallvaret copë sa s'ka ku të zerë qeni, — i qe përgjigjur Nazmija.

Bimi i dinte të gjitha këto. Ai priste me gëzim

ditën kur do tē vileyj mjalti. Herë pas here e pyeste t'émén:

— Moj noke, po kur do t'i shikojmë bletët pér tu marrë mjaltin?

— Në vjeshtë, xhan i nënës.

— Po kur vjen vjeshta?

— Pér dy muaj.

— Sa ditë janë dy muaj?

— Gjashtëdhjetë ditë.

— Janë shumë gjashtëdhjetë ditë, moj noke?

— Jo, shpirti nokes, jo. Ja, ikën dy muajt.

Dhe e éma i pérkëdhelte kokën me dashuri e me një dhemkë tē thellë në zemër.

Ajo nuk e shikonte dot tē birin ashtu me atë këmishë tē grisur e me shpatullat e vockëla tē dje-gura nga dielli. Nëna e mjerë e kuptonte se pérse nuk i durohej Bimit gjer tē vinte vjeshta. Dhe psherëtinte thellë sa herë që hapej kjo bisedë.

Bimi, mëngjes pér mëngjes, merte Lumen pér dore dhe shkonte tē luante nga lëmi. Bimi ishte plot tetë vjeç e kishte hyrë në nëntë. Lumja nuk i kishte mbushur akoma tre vjetët. Atje rrëzë murit, pak si nën hije, tē dy fëmijtë kishin bërë, një kaxhole dhe loznin buka-gjella. Në vend tē enëve, pjatave, filxhanëve kishin mbledhur copëra qelqi tē thyera ngjyra ngjyra, copa farfurish e poçesh. Bashkë me ta shkonin loznin edhe fëmijë tē tjerë tē lagjes.

Duke lojtur atje rrëzë murit tē lëmit, Bimi ndjente zukatjen e bletëve që shkonin lule më lulle e kullosnin. Në këtë kohë ai mendonte këmishët e reja, rrobat prej doku që do t'i vishte pér herë tē parë... Qeshte me vehte i gëzuar dhe si nëpér éndër shikonte veten tē veshur me rroba tē reja. I dukej sikur s'dinte tē ecte me to, sikur pengohej,

sikur e kishin vënë në mes fëmijtë e lagjes e i shikonin rrobat, dhe atij hem i vinte si turp, hem i vinte mirë t'ju mburrej. Kur zgjuhej nga kjo èndër dhe shikonte kërcinjt përjashta me ato të mba-thura rripa rripa, luste:

«Ah, sikur të mblidhnin mjaltë këto bletët aq shumë sa të blinte edhe nokja një fustan e babaj një palë shallvare!»

E në këto çaste, kur shihte ndonjë bletë që kulloste mbi ndonjë lule aty pranë, donte ta merrte në dorë e ta përgëzonte, por ato dreqka, të thumbonin.

Në mbrëmje, para se të flinin, i thoshte s'ëmës:

— Iku edhe një ditë, noke. Tani edhe sa ditë kanë mbetur të marrim mjaltin?

Erdhi një herë i ungji i Bimit nga Gjoçaj dhe i ati hapi një koshere dhe mbushi një sahan me mjaltë. Me këtë rast hëngri edhe Bimi. Sa i shishëm ishte! Sa herë i kujtohej mjalti i lëshonte lëng goja. Por kurrë nuk i kishte shkuar nëpër mend të kërkonte. Edhe kur i thosh e éma Veselit: «Or burrë, po na u thanë këta fëmijtë pér të ngrënë!» ai e pushtonte e i lutej: «Jo, noke, jo, nuk duam mjaltë ne» e menjëherë mendonte me vete si gjithmonë: «Ah, sikur të bënte edhe nokja një fustan!...»

Një ditë vjeshte, që në mëngjes herët, Kash-taji, fshati i Bimit, u gdhi i rrëthuar nga ushtarët e fashizmit. Fshatarët u ngritën të shkonin në punë, por fashistët nuk i lanë as të shkonin në ara as të kthehen në shtëpi. Brenda në fshat akoma nuk dinin gjë se ç'ndodhë rrëtheqark.

Me të rënë dielli, Bimi, si gjithnjë, mori Lu-men pér dore dhe shkoi të luante nga lëmi. Ato tri

a katër ditë kishin vendosur të vilnin bletët. Vëseli, që një ditë më parë, kishte vajtur të merrte një dy qypa te dajua i Bimit. N'ata qypa do të hidh-nin mjaltin për ta çuar në pazar.

Bimi sa po kishte filluar të loste miq e zonja. Miqtë quheshin njeri Bimi dhe tjetri Lume. Dhe ai, pasi u përshtëndet me ta, (të dy miqtë ishin dy shkopinj të veshur me lecka) po u thoshte: «Oooo sa të bukura i paske këto rroba, more Bimi! Sa i bleve, sa i bleve?» Pastaj i thoshte Lumes: «Po ti moj Lume, ku e bleve këtë fustan kaq të bukur?»

— Po unë s'kam fustan të bukur, — i tha e motra dhe ngriti prehërin e i tregoi fustanin tërë arna.

— Nuk të them ty, — i foli Bimi, — i them kësaj mikeshës që na ka ardhur. Po edhe ty edhe mua do të na blerë babai rroba të reja, për kaqë ditë. — Dhe i hapi dorën përparrë fytyrës duke numuruar gishtat.

E motra, e gjëzuar, e puthi disa herë atë dorë që i kishte zgjatur i vëllai. Ajo nuk dinte si ta falënderonte ndryshe Bimin për atë sihariq, dhe i thoshte:

— Dale të të puth dotrën Bimi. Dale të të puth dorën.

Në këtë kohë, aty afër shtëpive të tyre, u ndje një rrëmuje. Fashistët kishin hyrë tanë në fshat dhe po kontrollonin e po plaçkitnin dëré më dëré.

Bimi u ngrit më këmbë dhe, si u var në mur të lëmit, zgjati kokën të shikonte andej nga vinin zërat. Në mes të lëmit pa një oficer italian të veshur kreko. Me të parë oficerin, Bimi u tremb. Lëshoi duart e ra përdhe duke përdredhur pak këmbën.

— Djalë i vogël, eja këtu.

Oficeri fashist po i thërriste me një shqipe të çalë që mbi mur. Bimi, çalë-çalë, i vajti pranë duke i ardhur rrëth murit me Lumen për dore. Oficeri e përgëzoi e i fërkoi kokën:

— Çune mirë, çune mirë. Rrobe të reja, çune mirë.

— Edhe ky e ditka që mua do të më blejë babaj rrobe të reja, — tha Bimi me vete dhe e shikoi oficerin si me ndrojtje, por me plot sytë. Gjer atë ditë Bimi nuk i kishte parë fashistët. Ai kishte dëgjuar vazhdimisht që thoshin se fashistët ishin shumë të këqij. Me mendjen e tij pati kujtuar se kushedi çfarë fytyre të keqe do të kishin. Tani që i pa i erdhi si keq që flisnin me aqurrejtje për ta.

— Ku babai? Ku babai? — e pyeti oficeri fashist.

— Ka vajtur te dajua im.

Prapa kasolles kish një copë herë që po bë-hej rrëmujë. Disa njerëz qeshnin, thërrisin, po fjalët nuk u merreshin vesh. «Bletët! Bletët!» ndjeu sikur i thirri zemra Bimit, dhe bëri të vra-ponte për andej.

Oficeri e zuri për krahu, dhe duke ecur bashkë me të drejt bletëve, po pyeste:

— Ku babai? Ku babai?

Prapa kasolles tridhjetë a dyzet ushtarë fashistë italianë u kishin rënë përsipër koshereve të bletëve, i kishin shqyer së katërshti dhe po hanin me të dy bullçitë hoje të bardha mjalti. Bimit iu duk sikur kishin shqyer atë vetë e sikur i kafshonin zemrën. Vuri duart në kokë e thirri duke u drejtuar nga oficeri që ta mëshironte:

— Bobo, mjaltin! Të zestë ne, bletët! Të zestë ne, bletët!

U afrua ndaj oficerit. Ai e shtyu me shkopin e gjatë dhe pastaj u tha ushtarëve si pa të keq:

«Manxhiate, manxhiate!» Ata filluan përsëri të hanin. Bimi e kuptoi se «manxhiate» shqip donte të thoshte «hani». Atypératy, ftyra e bukur e oficerit, iu duk atij si ndonjë fytyrë kuçedre. Deshi t'i lutej përsëri, po oficeri e pyeti prapë:

— Ku babai? Partixhan, ë? Partixhan?

Këtë radhë ata sytë e tij dukeshin sikur lëshonin flakë si sytë e gjarpërit me brirë që i kishte treguar e éma në përrallat. Mori Lumen për dore që po qante me të madhe, dhe u drejtua nga shtëpia duke uluritur:

— Obobo, moj nënoke! Të zestë ne, moj nënoke!

Tek bridhte, i lëkundeshin pas kërcijve të tharë e të nxirë rreckat e brekëve të grisura dhe i dukej ajo copë lëkurë e djegur nga dielli në shpatullat e vogla ku i qe shqyer këmisha.

## **«KËTË MOS E HARRO, BIR! ..»**

Cenko Gurra kishte një javë që nuk delte në fshat. Gjithë ditën rrinte brenda, pinte duhan atje te këndi pranë zjarrit, një cigare e shuanë tjetrën e ndizte dhe mendohej. Dy nuset e mëdha bënin punët e shtëpisë; njëra gatuante në magje në fund të konakut, tjetra lante enët, fshinte e pastronte, dhe gjithë të heshtur vinin rrëth nëpër shtëpi si hije. Konakët dukeshin akull e si pa njeri brenda. Edhe fëmijët, nipër e mbesa të Cenko Gurrës, hynin e delnin pa bërë zë. Lozni të qetë në hajat ose vinin merrnin nga një copë bukë me gjizë apo me djathë në dorë dhe delnin jashtë në ndonjë qoshe ku zinte mirë dielli e nuk frynte erë. Gjënë e gjallë e nxirte pak përjashta, sa për të pirë ujë, Petriti, një djalth dhjetë-njëmbëdhjetë vjeç; pastaj u hidhni kashtë e i mbanin myllur ditë-natë. Në mbrëmje, pa filluar të errej, i vinin llozin portës dhe mblidheshin rrëth vatrës.

Dhe kështu ndodhë edhe në gjithë shtëpitë e tjera. Gjysma e fshatit: burrat, gratë e reja, nuset e çupat kishin shkuar e qenë futur në shpellat e malit, ashtu sikundër bënin sa herë që ndihej armiku afër. Edhe dy nuset e vogla të Cenkos, dy të mbusat dhe dy djemtë e mëdhej qenë futur ma-

lit lart, kurse dy djemtë e tjerë kishin shkuar partizanë që kur qe krijuar çeta e parë partizane në Skrapar. Më vonë qe hedhur me partizanët edhe një nip i xha Cenkos, ai më i madhi, Nuriu. Çdo familje në Arrishtë kishte një, dy ose më shumë partizanë, përveç shtatë a tetë shtëpive që qenë lidhur me Ballin Kombëtar e me okupatorët. Arrishtës armiku ja kishte vënë emërin «Moska e Vogël», siç pati quajtur edhe shumë katunde të tjerë të Skraparit, dhe gjer në operacionin e dimërit të viteve 1943-1944 nuk pati shkelur këmbë dushmani në këtë fshat. Në operacionin e dimërit e shkelën edhe Arrishtën. Këtu fashistët gjermanë vendosën shtabin e reparteve të tyre për atë zonë dhe rrinin në shtëpitë e bejlerëve.

Cenko Gurra, ulur në kënd, mendonte: «Shumë fuqi i kanë vënë këtë radhë. Si do të vejë halli vallë? Do ta hajë dot Partia edhe këtë radhë apo jo?...» Ballistët përhapnin lajme të reja mbrëmje e mëngjes: «Filan komandant partizan u zu i gjallë dhe e kanë varur te Sheshi i Bashkisë mu në mes të Tiranës. Një tjetër e zuri një gjyle dhe e ndau përgjysëm. Partizanët u shfarosën të gjithë. Kanë mbetur ca të pakët, të fshehur pyjëve, por edhe ata janë si morrat e fishkur; ose do të dorëzohen vetë. ose do vdesin urije të rrethuar...» Mëngjes, drekë, darkë hidhnin batare pushkësh për të festuar «fitoren e tyre» dhe shpejt hapet lajmi: «Kurveleshi u pastrua i tëri nga banditët partizanë». Cenko Gurrës, sa herë ndjente bataretë, i dukej sikur e kishin vënë pas murit dhe e pushkatonim.

Tërë jetën Cenko Gurra pat uruar: «O zot, sa gjallë e me nder. Vdekja me nder është kapak floriri». Pushtimi i Shqipërisë e zuri në një moshë të

thyer. Dora e këmba nuk i punonin më si atëhere kur, bashkë me Riza Cerovën, pat luftuar në Tepelenë kundra Italisë; në Berat; në Vlorë më 1920; në Shkallën e Tujanit kundra bashibozukëve të Ahmet Zogollit më 1924. Tani qe plak; hasmi edhe të zapton edhe të poshteron. Prandaj tani, më shumë se kurrë, plaku përsëriste gjithmonë me vete: «O zot, vdekje me nder». Atë vit që hyri Italia, Cenko Gurra do të martonte djalin e vogël. Por ai e shtyjti dasmën edhe motmot. «Është turp» tha, «të këndohet e të kërcehet sot në këto kohë në Skrapar, kur Shqipërinë e tërë e ka mbuluar zija».

Edhe në kohën e Ahmet Zogollit Cenku kurri s'qe i kënaqur, sepse sa kohë që mbretëroi Zogu, Shqipëria nuk ngriti kokë, gjithë po varfëria e mbulonte dhe papastërtia; shkolla nuk hapi Ahmet Zogu, rrugë nuk bëri, punë s'kishte, paraja u lidh, turpërohej burri për një çerek leku, sëmundjet nuk ndaheshin... Prandaj për plakun e maleve të Skraparit, kur këndonte, kënga që kish për zemër ishte:

*Në kohë të plegërisë  
Më zunë halle të rënda,  
Për shkakun e Shqipërisë,  
Që s'u bë si ma kish ënda.*

Por ardhja e fashizmit ja lëndoi edhe më keq shpirtin. «Ishim si ishim po kishim Shqipërinë tonën», thoshte me vete.

Me të ndjerë zërin e Partisë Komuniste, me të parë punët e saj e trimëritë e djemve që s'i u trëmbjë syri, po ja numëronin hasmit në lule të ballit mu në mes të ditës e në mes të pazarit, Cenko Gurra u lidh menjëherë me Partinë, se mendoi: the-

meli çati le të bëhet, po veç hasmin në vatër të mos e kemi dhe të marrë frysë i lirë ky popull; mjaft na ka vajtur thika në eshtë.

Lufta partizane në Skrapar shkoi mbarë që në fillim. Gjer në operacionin e dimërit, Skrapari s'qe shkelur ndonjë herë. Po ja tani u shkel. Lajmet që përhapte armiku ishin farmak të hidhura. Kishte një javë që vriste mëndjen Cenko Gurra pas vatrës se si do të bëhej më tej, po nuk e zgjidh-te dot këtë punë. Dy sopata i kishte mprehur mirë për të dy nuset, që t'i përdornin po ta donte puna, dhe i kishte vënë prapa magjes. Edhe përvete e kishte maliherin e shkurtër me veshë, që në luftën e parë, me njëqind e pesëdhjetë fyshekë, dhe e mbante fshehur në strehën e shtëpisë. Mirëpo kishte frikën e ndonjë befasie, se «qeni i lik të ha me të pabesë». Me burrat e fshatit kishte lënë fjalë se, po të shihnin ata me dylbi që andej nga mali një rrobe të kuqe të nderur te muri të oborrit, ta dinin se punët nuk ishin mirë në fshat, prandaj të uleshin natën e të vinin ta takonin të Dërrasa e Zezë.

Veç tërë këtyre të këqijave, n'ato ditë ankthi, Cenko Gurrës i qe bërë merak sa s'thuhet edhe sëmundja e një vajze që kishte martuar në fshat. E bija kishte tri javë në shtrat nga tifua e zorrëve. Më parë vinte vetë ditëpërditë dhe e shihte, po qëkur kishin hyrë gjermanët në Arrishtë, dërgonte fëmijët të pyesnin. Lajmet që merrte ishin të këqija. Atë mbrëmje kishte marrë lajm se e bija qe keq, fliste përcart dhe kur vinte në vete kërkonte t'i shkonte i ati ta shihte. Dy nuset e fëmijët ranë të flinin, po ai, gjithnjë pas zjarrit, mendohej: «Mirë dal, po si të dal kështu si grua pa asnë armë me vete?» Maliherin e shkurtër nuk e merrte dot,

po edhe revole s'kishte. Dy bomba, që i pat rojtur, ja kishin marrë djemtë në mal. Dhimbja për çupën ja ndrydhë zemrën. Darkë nuk hëngri. I bëhej tek e shihte të përpiquej në shtrat zjarr e tym nga koka e tek e thërriste, dhe i vinte të ngri-hej natën të shkonte ta shihte. Mirëpo gjermanët kishin dhënë urdhër që kush do gjëndej jashtë, pasi të errej, do vritej menjëherë. Ta paske marrë lajmin më herët do të kishte vajtur. Një kandil teneqeje u dogj në vatër tërë atë natë. Ojhaku dhe trarët pisë nga bloza nxinin si të lyer me sërë. Plaku u gdhi tërë natën ndenjur, duke dremitur herëpashere ashtu me shpatullat pas murit, i dërmuar nga dhëmshuria për çupën. Mëngjezi e gjeti prapë me cigare ndezur. Megjithse dimër e ftohtë, koha qe e mirë e qielli i kthjellët. Me të rënë dielli, nëpër të çarat e çatisë hynë rrezet e para e në konak u dukën njolla drite të shpërndara nëpër dysheme. Në dritën e ditës bloza vetëtinte me të zitë e saj në faqen e murit të oxhakut e në trarët. Nusja e madhe u ngrit e para, mori gjymin e mbushi me ujë, e vari në çengel dhe i vuri edhe ca dru të tjera zjarrit. Pastaj u ul në këndin tjetër e po bënte përsheshin e trahanasë. E pa që shtresat e plakut nuk ishin lojtur fare. Donte t'i thoshte një fjalë, po xha Cenkua kishte hije të rëndë. E mori me mënd pse ishte gëdhirë pa gjumë i vjehri atë natë dhe, më në fund, nga që i vinte keq për të, i tha:

— Mos ki merak, baba, se ja, sa të mbarojë mëngjezi dhe po shkoj vetë të pyes për Refijen si ka qënë natën.

— Jo, — foli plaku me një zë të vendosur, — nuk do të vesh. — Dhe po të thoshte ai «jo» kishte mbaruar, s'bëhej ndryshe. E reja ishte grua trime,

nuk i trëmbej syri. Një ditë më parë ajo kishte që-në në çezëm për të mbushur ujë dhe një oficer gjerman me ca ballistë pas, e kishte pyetur:

— Ku i kini meshkujt?

Ajo i qe përgjigjur:

— Ja ku janë.

Dhe kishte treguar me dorë balilstët që i shkonin pas gjermanit.

Xha Cenkua nuk ja kishte frikën asaj, se edhe po ta zinte vdekja, e reja dinte të vdiste me nder, por nuk i dha leje të shkonte, se kishte vendosur të vinte vetë.

Aty nga ora nëndë, pasi dërguan Petritin të shihte nëpër fshat mos kishte gjermanë në rrugët, xha Cenkua hodhi gunën krahëve, mori edhe Petritin për dore, se ju lut të vinte me të, dhe u nis për te e bija. Frynte një thëllim i hollë nga Tomorri që të thante. Fshati dukej si i shkretë e i varrosur mes malesh. Malet rretheqark: Tomorri, Koshnica, Ostrovica qenë mbuluar me dëborë. Në dritën e die-llit dëbora zbardhët e të vriste sytë.

Cenko Gurra ecte ngadalë nëpër rrugën e ngrirë. Siguronte njerën këmbë, pastaj mbështeste shkopin dhe hidhte këmbën tjetër. Me dorën e majtë mbahej pas Petritit. Ecte i rëndë e madhështor, me shpatullat të drejta, megjithëse shtatë-dhjetë vjeç burrë; mustaqet ngjyrë argjëndi dre-dhur. Graria e shihnin nga dritaret e fjaloseshin: «Xha Cenkua! ku po vete vallë? Mos e kanë thirrur gjermanët? Mos ka ndonjë lajm të mirë?»

Xha Cenkua, kaloi përmes fshatit i qetë e hijerëndë dhe vajti tek e bija, që e kishte shtëpi-në ndanë fshatit. Ajo e kish kaluar krizën, kishte rënë në qetësi dhe ndihej më mirë. Plaku u gëzua, piu një gotë qumësht i lehtësuar, kërkoi edhe një

tjetër, dhe i erdhi shpirti në vend. Nga mëraku që të shihte si do bëhej e bija, ndejti edhe për drekë te krushku.

Cenko Gurra s'kishte fjalë shumë. Asnjëherë atij nuk ja kishte ngrënë qeni shkopin e s'ja pat shkelur njeri hijen prapa. Kushdo që do të mendonte t'i bënte keq shtëpisë së tij, fshatarëve të tij apo miqve e shokëve, do t'i vinte gishtin kokës. Edhe njerëzit e qeverisë: kryetari i komunes, postkomandanti i xhandarmërisë, edhe nënprefekti i Çorovodës, i druheshin hijes së plakut të maleve, se siç shpreheshin për të «një herë të përpinqte pëllëmbët Cenko Gurra, një krahinë e tërë ngrihej më këmbë e i vinte pas».

Tërë këtë hije e këtë rëndësi nuk e kish fituar për hir të pasurisë apo pse qe nga ndonjë derë e parë. Jo; ai tërë jetën kishte rrojtur me djersën e vet, nuk i shtrinte kurrë këmbët më shumë se sa kishte jorganin dhe kurrë nuk ja pat zgjatur dorën njeriut. Kur e kishte dashur puna kishte luftuar për atdhe e nuk i qe trembur vdekjes dhe kishte mbajtur gjithmonë anën e njerëzve patriotë e përparimtarë. Me Avni Rustemin, me Fan Nolin, me Riza Cerovën..., me këta pati qënë ushtar e këta pat ndjekur pas. Fjalën e mbante si burrat. Nderi për të ishte më i çmuar sejeta. Fshati i mbante mënd shumë të mira dhe veç të tjerave nuk e harronte kurrë atë ditë kur ai mori tapitë e rrëme, që i kishin nxjerrë bejlerët në Çorovodë për t'i përvetësuar fshatit malin, duke i dhënë ryshfet gjykatësit, dhe ua grisi bejlerëve përpëra syve e ua hodhi coprat fytyrës. Duke u plakur, ai më shumë ja kishte rritur rëndësinë vetes e nuk kishte lënë, po më i urtë qe bërë.

Atë ditë, kur e panë njerëzia që doli xha

Cenkua në fshat e u duk tek kalonte i qetë, pa ditur si e kishte hallin, menduan se diçka të mirë do të kishin, ndonjë lajm të mirë do të kishte marrë.

Pasdite, xha Cenkua u nda nga e bija dhe, me Petritin për dore, u nis për në shtëpinë e vet.

Rrugës, duke ardhur tëhu, mu në mes të fshatit, ku kthen rruga te cepi i shtëpisë së Qemalit, xha Cenkua takohet ballë për ballë me një grup gjermanësh. Plaku ndjeu zemrën që i rrahu me forcë. «Hej të mallkuarit!» tha me vete dhe deshi të kthehej prapa. Por jo. Ishte shtatëdhjetë vjeç burrë dhe gjer atëhere nuk i kish dredhuar rrugë as mikut as armikut. Eci përpara i qetë...

Në krye të fashistëve ishte përsëri ai oficeri gjerman, komandanti i operacionit të asaj zone, që kishte takuar me të renë te çezma e fshatit, e që gjithë ditën pat vërejtur me dylbi sa në një breg në tjetrin. Pas i shkonin edhe plot oficerë e ushtarë të tjerë. Pas tyre qe edhe i biri i beut, i veshur oficer SS. Me të parë xha Cenkon, i biri i beut diç i tha në vesh komandantit fashist, sigurisht për plakun.

Xha Cenkua u ndodh dy hapa larg oficerit gjerman.

Oficeri i foli ca fjalë, po Cenko Gurra kuptoi vetëm pyetjen: «Partizan? Partizan?» Dhe ashtu siç ishte, i gjatë sa edhe fashisti, eshtërmadh, e vështroi drejt në bebe të syrit e nuk iu përgjigj.

E kuptoi plaku që i biri i beut e kish kallzuar.

Gjermani përsëriti pyetjen dhe xha Cenkua prapë nuk iu përgjigj duke qëndruar më këmbë përpara tij sypatrembur.

Atëhere oficeri ngriti dorën e djathëtë dhe e

qëlloi me pëllëmbë në faqet e rrudhura duke ulurit:

— Kaput partizan, kaput!

Plakut me thinja të bardha iu err botë. Si malet, kur i mbulon muzgu i mbrëmjes, u nxi u bë sterrë. Gjermani iu duk në atë çast sa një mizë. Shtrëngoi dorezën e shkopit të trashë prej thane, rëndoi mbi të, dhe faqja e djathtë zuri t'i lëvizte vetveti siç i ndodhët kur i hipte gjaku në tru; e vështroi gjermanin me ngulm, si ta përvëlonët me ata sy. Rrudhat e ballit, që i kishte hapur plori i kohës, iu bënë akoma më të thella e iu varën midis vetullave të vrenjtura.

Petri i vogël, po dridhej i téri. Gjyshi, gjyshi i tij, që c'thosh ai bëhej në shtëpi, që edhe i jati, edhe xhaxhallarët, edhe téré botë i druheshin aq shumë, tanë u poshtërua sikur t'ishte një copë leckë. Ai po vështronët nga plaku, i mbledhur si ndonjë tigër i vogël e sikur t'i thosh: «Hë, gjysh, ç'thua? t'i këcej në kokë këtij qeni?».

Plaku qëndroi dy sekonda ashtu, gati hundë për hundë me gjermanin, dhe pastaj tha me vete:

«Pse s'më vau ky qen, përpara se të më bënte këtë turp, or, iu thaftë krahu!»

Pastaj ktheu kokën nga i nipi dhe vazhdoi me zë të lartë duke vënë pëllëmbën e tij në faqen e goditur:

— Mos e harro këtë, bir!

Si faqja, si pëllëmba, digjinin njëra më shumë se tjetra.

Oficeri gjerman deshi t'ja përkthenin fjalët e plakut dhe ja bëri me shenjë të birit të beut, që rrinte gatitur më këmbë pas tij.

Ky ja përktheu. Oficeri qeshi me të madhe krejt i kënaqur që dijti ta prekë plakun e paepur aty ku i dhimbte më shumë.

Lajmi, që oficeri gjerman i ra me pëllëmbë mu në mes të fshatit Cenko Gurrës, u përhap si gjëmë shtëpi më shtëpi. Mbledhur kokë më kokë rrëth vatrës, bisedonin për këtë e secili e shpjegonte qëndrimin e plakut ashtu si e kuptonte. Ë shoqja e Qemalit, që e kishte ndjekur ngjarjen nga një frëngji, thoshte se e kishte parë xha Cenkon që kish hedhur dorën në bel, po si duket nuk i ishte ndodhur ndonjë copë hekur me vete, se nuk e linte xha Cenkua gjermanin pa vrarë. Dikush tjetër thoshte, se plakut i kishte ardhur keq për të nipin, se po të vriste ai gjermanin, do t'ja vrisin të nipin mu ndër duar. «Dhe evlati është kocka, po evlati i evlatit është palca e dhëmb më shumë». Pastaj, po të vriste ai komandantin gjerman, ç'do të bënин të tjerët? A nuk do t'i vinin zjarrin ata gjithë fshatit me gjithë njerëz brenda? Siç bënnë me Borovën? Jo, xha Cenkua ka menduar për tërë fshatin. Ai nuk do ta lerë këtë hakë pa marrë. Ai do ta shpjerë në vënd nderin e tij... Ndonjë i rrëmbyer, foli: «U tremb xha Cenkua. Ju dhimbjeta. U plak tani, nuk është më ai xha Cenkua i parë». Sidoqoftë, për tërë fshatin, turpi që iu bë plakut të maleve që një thikë në zemër dhe që të gjithë, për ngushëllim të tyre e për plakun, mendonin: «Një njeri me një mbretëri nuk mund të hahet. Sos e zuri xha Cenkon me një atje tej e s'qe i zoti t'i tregonte vëndin, po e zuri me një mbretëri këtë radhë. Dhe ai, ashtu siç ja punuan, ashtu do t'ua punojë. Është plak me mënd ai».

Cenko Gurra, me të vajtur në shtëpi, pa hyrë brenda, vështroi një herë a kishte edhe shumë orë ditë akoma dhe a dukej mirë, dhe u thirri nuseve:

— Më sillni atë anëjen e kuqe që shtrojmë për mysafirë.

Si e mori anëjen në dorë, shkoi nga ai krah i murit të oborrit që dukej nga ana e malit, e hapi rroben mbi mur që të dukej që nga mali dhe hyri brenda i zi sterrë si gllaniku.

I kishte ndodhur një gjë që s'e pat marrë me mënd kurrë, prandaj edhe nuk po dinte në bëri mirë apo keq që nuk e goditi fashistin me shkop. Atje në kënd, ku rrinte zakonisht, hieja e rëndë e dëshpërimit që i mbulonte fytyrën, si një re që s'e ngjet era, sa vinte dendësohej. «Jeta e njeriut i ngjan një të përpjete, së cilës i ngjitesh me gëzim sa je i ri; kur aftron pleqëria, me zor; dhe kur i del sipër në majë e sheh të tatëpjetën, të zë frika e vdekjes, frikë që, sa më tatëpjetë bën, aqë më shumë rritet, dhe ke çaste që të duket sikur vdekjen e ke aqë pranë sa të vjen ta ngresh dorën e t'i biesh, ta prapsësh, ta largosh. Atëherejeta të bëhet akoma më e dhëmbshur». Këto fjalë, që i kishte dëgjuar nga një plak në fshat kur pat qënë i ri, iu kujtuan Cenko Gurrës, ndofta për të parën herë në jetën e tij, atje në këndin tek rrinte si një statujë e palëvizur e dëshpërimit. Kishte lotë zemërimi, por ja ndalonte burrëria. Të dy nuset u panë sy më sy e dualën jashtë.

— Diç i ka ngjarë babait, ose diç ka marrë vesh, — foli nusja e madhe. — Të zezat ne, kemi djemtë e burrat!... — Ajo s'e mbaroi fjalën, kur nusja tjetër u nis për të mësuar gjë andej nga çezma e fshatit.

Xha Cenkuua nuk hëngri darkë. Mori nipçen tre vjeçar, në prehër, gjë që nuk e kishte bërë kurrrë në jetë, as me djemt e çupat e tij, as me nipër e mbesa, dhe ndenji me shpatulla mbështetur pas murit duke e lënë të voglin të lozta me mustaqet qile të dëndura. Shkoi nëpër mënd si pat punuar

e robëtuar për të mbajtur shtëpinë, rikujtoi si qe gjëzuar sa herë që i patën dhënë sihariqin kur i kishin lindur fëmijët, dasmat e djemve e të vajzave. Kujtoi si kish shtuar edhe dy konakë kur iu rritën fëmijët, si i kishte prurë trarët më kra-hë që nga malli i Kuçit bashkë me shokët. Ham-barët i pati bërë po ashtu që në atë kohë. Mos vallë po pëershëndetëj kështu me gjithçka të dashur, me gjithçka që i pat falur çaste gjëzimi e lumturie, si edhe çaste hidhërimi? Çfarë kishte ndër mënd të bënte? Ç'vendim do të merrte? Si kaluan nj'a dy orë natë, doli përjashta në oborr. Nata flinte mbi shtrat dëbore, e zezë sterrë, e egër dhe e ftohtë. Fshati, si me shpatulla të mbështetur pas malit, nuk ndihej as i gjallë as i vdekur. «Jo, është shpejt akoma». Hyri përsëri brenda. Zjarri, si një njollë gjaku, skuqte në vatër. Xha Cenkuia i puthi fëmijët para se të flinin. Kurre s'e kishte bërë një gjë të tillë, sado që linte kokën për ta. Nuseve iu shkoi një e ngjethur nëpër trup dhe ndejnë t'u dridhej zëmra. Menduan me tmer. «Pupu! Kushedi ç'ka ndër mënd të bëjë!»

Kur të gjithë flinin, xha Cenkuia hodhi gnnen krahëve, mori malipherin e shkurtër peshë në dorë dhe rrëshqiti si hije. Kaloi nëpër koridor, nëpër oborr, e duke ecur i kërrusur kaloi nëpër një vijë uji nga s'kishte dëborë, për të mos lënë gjurma, dhe arriu te Dërrasa e Zezë. Pesë hije të zeza po zbrisnin shpatit të malit tatëpjetë. Ata ishin burra nga fshati i tij. Me t'u afruar, dhanë shenjën duke shkrepur me uror. Xha Cenkuia u përgjegj.

— Si jini, baba?

— Si jini, xha Cenko?

Edhe në zërin e të birit edhe në atë të katër

të tjerëve ndihej druajtja e ndonjë lajmi të kobshëm dhe e padurimit gjersa të mësonin se si ishin njerëzit që patën qëndruar në fshat.

— Mirë djem, mirë jemi.

Por ata nuk dallonin dot nëpër terr si nxinte e sterronte plaku në fytyrë.

Burrave u shkriu gjaku.

— Ne kemi lajme të mira, baba, — i tha Hajriu, i biri. — Në Téndën e Qypit, brigada e parë dhe grupei i Skraparit i kanë dërmuar gjermanët. Po presim të na lajmërojnë që t'u biem edhe në këtyre këtu, — dhe tregoi me kokë fshatin.

— Mirë, — foli plaku, pa u kallzuar ç'i kishte ngjarë atë ditë, — edhe unë për këtë kam ardhur; të marr vesh ç'do të bëjmë, do të rrime kështu me duarkryq, apo...

— Ne do t'i godasim kur të ikin nga fshati. Ti baba do të na lajmërosh kur të ikin. Në shkofshin rrugës nga Kulat do të na japësh shënje duke nderë një robe të bardhë mbi çati. Në shkofshin nga Zharrëzat, do të nderësh një trobe të bardhë e një të kuqe.

Kështu, mbasi bënë planin e lanë shënjet, u ndanë.

Pas dy ditësh, forcat gjermane që kishin qëndruar në Arrishtë u nisën. Ata nuk shkuan as nga Kulat as nga Zharreza. Si duket kishin marrë urdhër të ktheheshin në Elbasan. Xha Cenkua, pa u menduar gjatë, thirri Petritin dhe e dërgoi në mal, duke e porositur që ata të malit t'ua zinin fashistëve në Qafën e Shtyllës. Vetë nxori maliherin nga streha ku e kishte fshehur, e hodhi në sup me grykë posht, hodhi edhe gunën krahëve dhe doli jashtë. Në mes të oborrit qëndroi një çast i menduar sikur të kujtohej mos kishte ha-

rruar gjë. Balua, qëni i shtëpisë, iu shtri përparrë këmbëve e po i përgëzohej. Ca pula që u trembën kur doli Balua nga koteci i vetë, dolën në oborr e po kakarisnin. Dy nuset po rrinin në këmbë me fytyra të zbeta te praku i derës pa guxuar të pyesnin ku do shkonte e ç'kishte ndër mënd të bënte. Plaku kishte shumë për t'u thënë. Donte t'u thoshte t'ja bënin hallall, të ruwanin nderin e shtëpisë, të kishin amanet fëmijët... Nipçen e vogël këmbëzbathur, që dridhej nga të ftohtit në prak të derës, donte ta puthte... Po më në fund ktheu kryet, pa edhe një herë duke hedhur sytë rrëtheqark strehëve të shtëpisë dhe iu drejtua nuseve pa i vështruar në sy:  
— Jepuni ujë atyre qevet, se harrova pa u dhënë dhe hapni sytë këtej nga shtëpia.

Pastaj dëbora e ngrirë kërciti nga hapat e tij dhe dy nuset vunë re se si nuk i hiqte sytë nga buza e Qeshteve, ku po kalonin ushtarët fa-shistë varg njeri pas tjetrit.

Tri orë më von, në Qafën e Shtyllës, krisi në fillim një mitralos i rëndë «Breda». Pas tij batare pushkësh, bombash dhe lufta u ndez.

Xha Cenkua, duke ecur mbi udhë e ndënë udhë, në drejtim të gjermanëve, nuk u ishte ndarë këmba këmbës. Oficerin e gjatë gjerman, që e pat goditur me pëllëmbë, e shquante mirë midis të tjerëve. Me të plasur luftimi, ai tha me vete: «I goditën! Hë, m'u lumtë, or djem!» dhe qëndroi i fshehur pas një guri. Oficeri që e pat goditur filloj të jepte urdhëra duke u cirur dhe duke treguar sa me duar me këmbë vëndin nga krisi mitralozi i parë. Plaku e pshteti maliherin në një të çarë të gurit e ja drejtoi oficerit në mes. Që kur ishte i ri pat dëgjuar, se kur e fut armikun në grykë të pushkës e ai të duket i madh,

atëhere mblidhe këmbëzën se e ke të vrarë, por po t'u duk armiku i vogël e ndofta sa një mizë, mendohu se zor ta goditësh. «Dashi», siç pat filluar ta quante ai oficerin që nga çasti kur bënte planet që ta vinte në grykën e malipherit, nuk po ja mbush-te syrin. «Kurrë plumb bosh s'më ka shkuar», tha me vete, «si të më ikij ky!» dhe u ngrit të afrohej edhe ca, duke ecur përmbyss nga guri në gur e nga shkurrja në shkurre. U afrua gjer në një farë vendi dhe ndaloi pas një gërmadhe. Atje u shtri barkaz, e mbështeti mirë pushkën dhe mori shenjë. Oficeri ishte qetësuar e nuk po gjirej më, por po vështronë me dylbi. Rreth tij kishte edhe të tjerë me sytë të ngulur nga vëndi, ku po zhvillohej përpjekja. Plaku ndenji një çast me frymë pezull, gishtin në këmbëz e syrin e djathëtë në shënjestër dhe drejt në dylbitë e fashistit. Tani i kishte lindur dëshira ta godiste një herë e mirë, se po t'ja mbante nga gjoksi kishte frikë mos plagosej e shpëtonte. «Dashi» po i dukej në grykën e malipherit sa një dash i vërtetë dhe e mblodhi këmbëzën e parë, pastaj të dytën. Krisma e thatë me dy ushtima vazhdonte akoma të jehonte rrëzë Tomorrit, duke ja përcjellë shpella shpellës e gryka grykës, kur xhamat e dylbive të fashistit u vërtitën në erë dhe trupi i madh i tij u rrotullua një herë rreth vetes e u këput e ra përmbyss me krahët hapur.

Shtabi i fashistëve dhe ushtarët që i shoqëronin u hutuan në fillim, se nuk e kuptuan nga u vajti ai plumb. Por i biri i beut, që i shkoi menjëherë mëndja te Xha Cenkua, e mblodhi shpejt veten dhe bashkë me një oficer gjerman e ca ushtarë bënë këmbë në drejtimin nga u ndje krisma, zunë pozicion dhe shtinë.

Për më se gjysëm ore, ndërsa në Qafën e

Shtyllës vlonin pushkët, mitrolozat, bombat e murtajat, prapa shpinës së forcave fashiste u dëgjua edhe një përpjekje tjetër. Përmes breshërisë së automatikëve e mitralozit që shpërthente mbi gurët ku qe pshtetur xha Cenku, kohë më kohë ndihej edhe maliheri me dy krisma i plakut, i cili donte të mos i shkonte asnje plumb bosh.

Tri ditë pas kësaj përpjekje djemtë dhe i tërë fshati shkuan e ngritën Xha Cenkon të vrarë mbi gurët e mbi dëborën që akoma skuqnin nga gjaku i tij.

Udhëtarët që u bie rasti sot të kalojnë në ato anë, lexojnë në një lapidar që është ngritur atje: «Këtu luftoi dhe u vra patrioti shtatëdhjetë vjetar, Cenko Gurra, i cili jetoi dhe vdiq me ndër».

## NE DITE TE VESHTIRA

Kur filloi operacioni i dimërit i viteve 1943-44, batalioni partizan «Riza Cerova» u ndodh në Qafën e Dardhës; katër pesë orë larg qytetit të Beratit. Herë kjo qafë, herë Qafa e Pazjanit, një orë e gjysëm larg qytetit, dy vjetët e fundit të luttës, ishin si kufi midis forcave Nacional-Çlirimtare dhe atyre gjermano-balliste. Batalioni «Riza Cerova», me gjithë vullnetarët nga fshatrat e Tomorricës, kishte rrëth katërqind pushkë. Fashistët gjermanë dhe ballistët sulmonin atij krahu, në veri të Tomorrit, me njëmijë e pesëqind veta. Këtë shtabi i batalionit e mësoi nga dokumentat që iu gjetën në xhep një komandanti ballist, i cili u vra që në sulmin e parë në krye të fshatit Dardhë. Beteja vazhdoi e rreptë dy ditë e dy netë, pastaj, forcat partizane, meqenëse, mbetën vetëm me nga pesëmbëdhjetë e njëzet fishekë, u tërroqën dhe hynë në pellgun e Tomorricës, prapa malit të Tomorrit. Këtu bënë edhe një qëndresë tjetër të fortë për dy ditë të tjera në Qafën e Tërrrovës, dhe mësuan se forca të tjera fashiste i sulmonin nga Elbasani e nga Korça. Prej kësaj ata e kuptuan se ky ishte një operacion i gjérë i armikut. Në këtë kohë disa nga partizanët nuk kishin më shumë se nga një e nga dy ballë fishekë. Në katundin Zaloshnjë, ku u bë qëndresa e tretë, ba-

talionit i arriti urdhëri i shtabit të grupit të Beratit që të têrhiqeshin, të futeshin thellë Skraparit dhe të maskoheshin nëpër pyje e male, ku ishin futur edhe qindra e mijëra njerëz nga populli, — pleq, plaka, gra e fëmijë, — pér t'u mbrojtur nga masakrat e armikut.

Skrapari është një vend ku, siç i thonë fjalës, ha pulë gurë. Kishin ç'kishin familjet fshatare, e ndanë me partizanët.

Xhemil Abazin shtabi i batalionit e caktoi në krye të nëndë të rinxve, me detyrë që të bënin roje në një kodër, se mos rrëthoheshin befasisht nga armiku. Kodra ishte e veshur me lisa dhe, në majë të saj, ishte shtëpia e një skaparjoti. Shtëpia kishte tre konakë të përdhesëm, të fshehur midis drurëve viganë; i tërë fshati ishte ndënë të. Prej andej rrëtheqark shikoje me dylbi lëvizjet në çdo qafë e grykë dhe fshati i njante një foleje shqiponje majëmalë, siç janë gjithë fshatrat e asaj krahine. I zoti i shtëpisë, Nike i thoshin, që nja dyzet vjeç burrë. Vinte i shkurtër me trup e thatim në fytyrë. Ai nuk kishte lojtur nga shtëpia, sepse, në rastin më të parë që do të diktohej armiku, mund t'i futej shpejt shpejt malit përpjetë me gjithë fëmijë e të mos e gjenin dot kurrë. Të dhjetë partizanët, bashkë me ta edhe Nikja, që dinte shtigjet më të fshehta nga mund t'i udhëhiq-nin tradhëtarët forcat gjermane pér të rrethuar partizanët, bënин roje ditë e natë majë kodrës dhe në ditët e para hanin vetëm një herë bukë në njëzet e katër orë, duke marrë nga një copëz se-cili. Pastaj Nikja filloi t'u jepte më rrallë, pa u thënë se si e kish hallin, se i vinte turp. Ditën e shtatë, Nikja lëshoi në sofër pér darkë një bukë të zezë. Fytyra i nxinte më keq se buka. «S'kam

ç'bëj, o shok e vëllezër, — u tha partizanëve, — bukë urovi është, po s'kam tjetër. T'i hamë edhe ato tridhjetë kile urov që kam, dhe pastaj...» Ai nuk e mbaroi fjalën, po ngriti kokën dhe pa me vështrim të ngulur në një vend të pacaktuar në faqen e murit. Të tre fëmijët e Nikes po flinin në kënd të mbuluar me ca rrobe të leshta. Hurmaja, e shoqja, kishte ngrënë darkë edhe ajo që më parë e diç po arnonte e ulur përfund këmbëve të fëmijëve. Në trupat dhe në shpirtërat e secilit prej njerëzve që ishin rrëth vatrës së Nikes ketë natë dukej sikur forca e jetës shteronte përorë. Kur tha Nikja «Bukë urovi është, or vëllezër...», të dhjetë partizanëve u mori fytyra një shprehje më të menduar e më të dëshpëruar akoma. Asnjeri nuk e hapi gojën të fliste. Heshtja ishte në këtë çast aqë e thellë sa ç'ishte e rëndë tortura e urisë që po i tretëte ca nga ca këta njerëz.

Më në fund, Nikes, pas okërrit e tërshërés, iu mbarua edhe urovi dhe filloi të merrte urov hua nëpër shokët.

Një natë, dëbora që kishte filluar që në drekë, vazhdonte të binte me flokë të mëdhej dhe tufani e suferina fërshëllënин në një mënyrë rrëqethëse. Nuk delte dot jashtë ariu e jo më njeriu. Partizanët po përtypnin bukën e urovit të menduar. Nikja po çante pishë në fund të konakut me një sqepar të vjetër. Hurmaja dhe fëmijët, si çdo natë, ishin mbledhur në këndin ku flinin përhera. Dy nga fëmijët qenë shtritur, kurse vajza e mesme gjashtë vjeçare kishte vënë kryet në gjurin e së jëmës dhe kohë më kohë i lutej:

— Nënë! Bukë! Vdiqa për bukë! A u bë më-mëlikja?!

— Ja, shpirt' i nënës, sa të bëhet dhe do t'ju jap, — i përgjegjej e jëma.

— Po jepi, — i tha Xhemili dhe mori një kafshatë nga pjesa e tij e ja zgjati vajzës.

— Këta e hanë pjesën e tyre që në aksham, — u përgjegj Hurmaja, — dhe flenë, por sot nuk e di se ç'kanë që nuk i ze gjumi. Unë kam vënë kusinë në zjarr t'u bëj mëmëlike, po s'ka zjerë akoma.

Vajza e gëlltiti njëherësh atë kafshatë që i dha partizani dhe po vështronë e uritur kusinë e mbuluar me kapak që po vlonë në zjarr.

Pas ca zëri i saj i mekur u ankua përsëri:

— Akoma s'ka zjerë, moj nëne?

— Akoma, shpirt, akoma.

Dy fëmijët e tjerë ngrinin kokën, që ndënë rroben e leshtë, me fytyra të tretura e sy si të një-riu që vjen në vete pas një alivanie të gjatë, dhe kohë më kohë ankoleshin edhe ata:

— Nëno! po vdiqëm pér bukë, moj!

Hurmaja, herë heshtë pa i hequr sytë nga zjarri, herë u përgjegjej me një zë të shuar, që delte nga kraharori, ku dhembja e pikëllimi i në-nës ishin bërë gur.

Më në fund fëmijët i zuri gjumi. Nëna u ngrit, e mori ngadale përpara duarve vajzën, e vuri në radhë me dy të tjerët, e mbuloi dhe pastaj mori kusinë e e shpuri në fund të konakut, në qoshe.

Kjo skenë u përsërit tri netë me radhë. Partizanët, tek i shikonin fëmijët të këputur nga urija e tek i dëgjonin t'i luteshin s'ëmës të hiqte kusinë nga zjarri e t'u jepte mëmëlike, i thoshin Hurmاسë, megjithëse nuk donin me asnje mënyrë t'i ndërhynin në punët e saj:

— Jepu, në ke pér t'u dhënë. Ç'pret më!

Në zërin e tyre ndihej dhimsuria pér të vegjëlit. Hurmaja e kuptonte këtë dhe vështronë sa

nga fëmijët nga partizanët me një buzëqeshje të rreme e të akullt, që i endej për një çast në buzët, dhe përgjigjej:

— Po, do t'u jap, sapo të bëhet.

Zëri i saj ishte i lodhur, i këputur dhe tregon-te se, nga çasti në çast ajo ishte gati të shpërtihente në vaj. Pastaj ajo mblidhë fort buzët e holla, për të përbajtur me forcë dhimbjen që i vlonët në krahëror.

Era vazhdonte të frynte e tërbuar. Dimëri përplaste nëpër hatulla grushte-grushtë dëborën. Partizanëve u rrëqethet shpina nga mornicat, ca prej të ftohtit, ca sepse s'dinin si t'i ndihmonin këta njerëz në vojtje, edhe veten e tyre bashkë me ta.

Kur merrte kusinë Hurmaja dhe e çonte në fund të konakut, Xhemili bënte lloj-lloj pyetjesh me vete: «Përse nuk u dha nga një lugë fëmijëve?... Mos vallë nga që po t'u jepte atyre do t'i duhej t'u jepte edhe partizanëve, kurse kështu ata nesër ditën mund ta hanin të gjithë vetëm?...»

Disa herë qe matur t'i thoshte se ata nuk donin, por le t'u jepte fëmijëve. Më vonë, kur kujtonte që nuk e bëri këtë marrëzi, ndjente një lehtësim në zemër....

Natën e tretë, si i pat zënë gjumi të gjithë, të paktën kështu iu duk Xhemilit, ai u ngrit me ngadale dhe shkoi në fund të konakut. Kusia ishte vënë midis magjes e një sëndyqi, mbi një dërrasë të gurtë. Xhemili i hoqi kapakun dhe futi dorën brenda. Ajo qe mbushur me bluashka lisi e me ujë dhe nuk qe ftohur akoma, gati të digjte. U rrëqeth i téri. «Ja, c'qënka!» tha me vete duke i vërvshuar në të gjithë trupin një valë e nxehë dhe duke e pushtuar një ndjenjë e fortë dhimbjeje.

Gjatë jetës partizane ai kishte patur raste t'i vriteshin shokët dy hapa larg. Kishte mbajtur të plagosur në krahë me orë të tëra, duke dëgjuar rënkimet e tyre. Ishte plagosur edhe vetë dy herë. Herën e dytë qe tërhequr zvarrë me orë të tëra në piskun e vapës. Kishte varrosur shokë. Kishte varrosur, — dhe kjo kishte qënë më e tmershmja për të, — një këmbë ose një dorë të shokut, porse megjithë këto, ai nuk mund të gjykonte dot, atje në atë cep të errët të konakut, në ishte në atë çast më pak i prekur në shpirt nga kjo ngjarje e re e papritur.

Mbajti vesh një sekondë me kryet kthyer pas në terrët, me ndjenja të turbulluara mos e kishin ndjerë të zotët e shtëpisë dhe pastaj, i kërrusur e me majat e gjishtrinjëve, shkoi në vëndin e vet e u mbështoll me kapotën. Njëri nga fëmijët foli përsëri përqart:

— Nënë! Bukë!... Zjeu?... Akoma nuk ka zjerë mëmëlikja?...

Xhemili, i mbledhur shuk pas zjarrit, mendohet: «Partizanët nuk kishin biseduar me njeri tjetrin për «kusinë me mëmëlike». Ndofta, ashtu si Xhemili, mund të kishin dyshuar edhe ata, se Hurmaja donte t'u jepte yetëm fëmijëve, porse asnjeri prej tyre nuk e pati parë si gjë të padrejtë këtë veprim dhe asnjerit nuk i kishte shkuar ndër mend të vërtetonte dyshimin e tij; kurse ai...»

Dhe ndofta për këtë shkak, edhe sot pas njëzet e ca vjetësh, Xhemilit, sa herë që i kujtohet kjo natë, i vërshojnë valë të nxehta nëpër gjithë trupin, skuqet si atëhere dhe thotë me vete, si t'i ketë përpara Niken e Hurmanë:

— Në më kini ndjerë tek zbulova kusinë, më falni o Nike e ti Hurma! Më falni o Njerëz!

## MËSUSJA

Oborri i shkollës zjente nga zërat e fëmijëve. Ata ishin veshur si pér ditë feste me rrobat më të mira. Bashkë me ta kishin ardhur edhe prindët. Atë ditë ishte mbyllja e vitit shkollor dhe do të ndaheshin dëftesat. Një grup burrash e grash, ndënnë hijen e mënxit të madh në cep të oborrit, po këndonin:

*Malet me dëborë,  
Fushat jeshilojnë,  
Gëzo Shqipéri,  
Shqipëria jonë.*

Garentina, mësuesja e klasës së tretë «A», kishte dalë në dritaren e fundit të klasës së saj, kish kryqëzuar duart, e ashtu e mbështetur në prag të dritares vështronte nga Tomorri pér karshi, e kredhur në mendime sikur të mos ndodhët asgjë përreth. Sytë e saj të kaltërt si qelli i bukur e i kthjellët i qershori ishin të mallëngjyer.

— Mësuese, — iu lut një pionier që kishte rolin kryesore në njërin nga skeçet që do të çfaqeshin atë paradite pér prindët, — të lutem na shiko një çikë...

Ajo, pa lojtur asnjë grimë e pa i hequr sytë nga Tomorri, ku një re e hollë dukej si çember i bardhë karfosur në majë të tij, iu përgjegj:

— Po ju dëgjoj, mirë e kini.

Kishte tre vjet që kur Garentina kishte mbaruar pedagogjiken. Që vitin e parë ajo qe emëruar mësuesë në shkollën shtatëvjeçare «5 Shtator». Tre vjet që punonte në atë shkollë. Fëmijët i mori në klasën e parë dhe ja sot do t'u jepte dëftesat e së tretës. I mbante mënd fare mirë ashtu të vegjël, të drojtur, të urtë sikundër janë fëmijët e fshatit, dhe ja tani ata janë rritur, zhvilluar... por gjithmonë të dashur e me nderim të thellë ndaj saj.

Cudi! me ç'ndjenja e mendime erdhi vitin e parë që u emërua këtu e me ç'ndjenja e mendime largohet prej këtej çdo vit shkollor!

Duke ndenjur e palëvizur atje buzë dritäres, ajo rikujtoi si e kishte pritur lajmin e emërimit në këtë vënd. Ishte gusht. Gati në këtë orë — në orën tetë ose nëndë të mëngjezit, shoqja e saj, Shknëdija, kishte hapur derën me vrull e i kishte thirur: «Tina, na doli emërimi...!» Rikujtoi udhëtimin e parë që kishte bërë. Sa e gjatë i qe dukur rruga! Në çdo pesëdhjetë metra kishte një kthesë. Sa vinte, rruga bëhej më e përpjetë. Makina, duke u ngjitur, gulçonte. Me të arritur në një majë, që dukej si më e larta e pandehje se s'do të kishte tjetër pas saj, ja tek qfaqeji një më e lartë; dhe të tjera akoma dukeshin në sfond sikur haheshin me shoqja-shoqen kush të hynte më thellë në gjitë qilllit. Gjithnjë e më shumë pikpyetje në kokëkin e vajzës: kur do të arrinte në fshatin e caktuar? Edhe sa orë udhë do bënte me kafshë, pasi të mbaronte rruga me makinë? Çfarë fshati do të

ishte ai ku do tē shkonte? Me ç'njerëz do tē kishte tē bënte?... Ajo kishte vështruar e mahnitur vën-det e reja, tē panjohura, dhe me mënd kishte përsëritur vargje tē tëra tē Bajronit, kushtuar buku-risë së egër tē maleve tonë:

*Na la pa mend magjia ngyrëylberi!  
Shkëmbej e prrenj e pyll e qiell i rimtë*

. . . . .

vargje që ajo i kishte recituar aqë bukur në mbrë-mjen e maturës.

Rikujtoi rrugën që kishte bërë me kafshët nga qëndra e rrrethit gjer në fshat. Si kishte patur frikë tē hipte në kalë, si i merreshin mënd tek vë-shtronte përrenjt e thellë që sipër gërxheve, si kishte patur frikë me muaj tē tërë se mos binin shkëmbënj nga mali dhe zinin ndënë vetë fshatin, shtëpinë ku flinte. Kurse tani, duke soditur me radhë fshatrat përkarshi njerin pas tjetrit, që duke keshin si tē zënë dorëpërdorë me shoshoqin, i vinte turp me veten e saj pér frikën që kishte patur. Ajo qe mësuar tani tē ecte me kalë, e në këmbë me orë tē tëra, pa iu bërë pshikëza në këmbët; pat zbritur e qe ngjitur nëpër shkrepë... Dhe duke menduar kështu e ripushtoi, sikur ta pështillte edhe më fort, gëzimi i kthimit në qytet, pranë familjes; kujtoi me gëzim shëtitjet në bulévard. Një grup fëmijësh tē klasës së saj ishin ulur përkarshi dhe e vështronin tek mendohej. Në sytë e tyre shkrepëtinin xixa gëzimi. Herë pas here u hidhte edhe ajo sytë. Por çudi! Çfarë ndjenjash tē pakuptuara i vlonin në shpirt! Edhe i vinte mirë që i shihte ashtu tē qeshur e tē lum-tur, edhe nuk i vinte. Ajo po ndahej me ta. Ishte xhelozë pér ato mësues apo mësuesë që do t'i

mësonin në të katërtën, në të pestën e me radhë. Sytë e tyre nuk do ta vështronin me adhurim. Po vallë a do ta kujtonin më? I dukej sikur diçka e padukëshme po e xhvishte nga një lumturi që e rrighthonte, e që e kish bërë të mos ndjente as lodhje, as mërzi... Herë herë i vinte si inat edhe me fëmijët; përse e ndjenin veten aqë të lumtur? Ata duhej të ishin të dëshpëruar që po ndaheshin me të. U hodhi vështrimin e i pa një nga një me ngulm si t'u drejtonte njëmijë pyetje që kish në kokë e të vegjëlit, si t'ja kishin kuptuar gjithëçka i vlonët në zemër, e panë me sytë plot mallëngjim. Hështja e tyre, nemitja e tyre në çast, pas vështrimit të saj, i foli për shumë gjëra.

— Bukurije, — i thirri pionieres që pat dashur aqë shumë.

— Urdhëro, mësuese. — Ajo u ngrit më këmbë.

— Eja këtu.

Bukurija i shkoi pranë. Mësuesja i zgjati duart. U zunë të dyja duarpërduar si dy shoqe, si dy motra. Asnjera s'fliste, po që të dyja, me sytë e lagur i thoshin shumë njera tjetrës. Më parë mësuesja asnjë herë s'e kishte afruar në këtë mënyrë, t'i zinte duart, se ajo ishte mësuese, tjetra nxënëse. Porse tani... Fëmijët e tjerë qenë ngritur të gjithë vetvetiu në këmbë dhe vështronin nga dritarja si të prisnin t'i ftonte edhe ata.

— Ejani, u thirri Garentina.

Të gjithë i shkuan grumbull përpëra.

— Pse nuk lozni?

— Ne lozëm gjer tani.

— Që kur kam dalë unë në dritare ju nuk kini lozur.

— U lodhëm, — foli vetëm një zë. Po për të

gjithë, edhe për mësuesen vetë, ishte e qartë se fjala u «lodhëm» nuk shprehte të vërtetën.

Garentina férkoi ballin me dorë si të largonte që andej një mendim jo të këndshëm dhe u tha me zë të ëmbël e përkëdhelës:

— Shkoni, lozni, gjëzoni... — Pastaj, e nxitur nga dëshira për të ditur sa u dhimte të vegjëlve për të, shtoi: — Unë nesër do të ikij, dhe...

Ajo nuk e mbaroi fjalen. Toni me të cilin foli të bënte të kuptoje se do shkonte e nuk do të kthehej më në atë shkollë.

Fëmijët, krejt vetveti e pa drojtjen që kishin patur gjithmonë, u shtrënguan të gjithë pas saj, i mbërthyen duart e nuk po e lëshonin, duke thirrur njëherësh:

— Mësuese! mësuese!...

Ata e vështroin me sy pyetës e i luteshin me vështrimin e tyre:

«Mos na lerë, mësuese! Eja prap mot! Rri këtu përgjithmonë me ne. Pse thua se do na lësh?»

A mund të rrinte edhe për shumë vjet me këta fëmijë? A mund të rrinte për gjithmonë në këtë vënd, me këta njerëz? Kjo i ishte dukur e tmershme Garentinës kur kishte lexuar e rilexuar me duart që i dridheshin urdhërin e emërimit tre vjet më parë, ku shkruhej: «Ju njoftojmë se...»

Në këtë kohë, si ta kishte harruar shkakun e vërtetë që e kishte bërë ato ditë të lumtur sa s'thuhet, por që i kishte shkaktuar edhe ndjenja aqë të turbullta, shpejt vuri dorën në anën e majtë të krahërorit, kapi atje një zarf me dorë, dhe u tha fëmijëve me zë të ëmbël po urdhëronjës:

— Shkoni tanë, lozni.

Fëmijët u larguan. Garentina i ktheu kurrizin

dritares, futi dorën në gji, nxori që andej një zarf e nga zarfi dy letra. Në njérën, të shtypur në shtypëshkronjë e të mbushur mandej me dorë, shkruhej: «*Fletë-Lavdërimi — Mësues Garentina Çeliku...*» Ishte e dyta fletë-lavdërimi që merrte. Sado që e kishte provuar lumturinë që fal puna, prapseprap kësaj të fundit i gjëzohej akoma më shumë. Po pse vallë? Mos pse fill një ditë pas saj postjeri i kishte prurë edhe këtë tjetrën, ku shkruhej:

«E dashur Tina,

Më në fund po të jap lajmin më të lumtur që kemi pritur unë e ti. Provimet e shtetit i dha-shë. Po të pres pa durim... Tani le ta dijë gjithë bota dashurinë tonë. Vera e këtij viti do të jetë vera e martesës sonë.»

E rilexoi këtë letër, pas kushedi sa herësh. gjatë atyre njëzet e katër orëve, dhe duke u mbushur me frymë si të donte të fuste në krahëror tërë erën e atyre maleve, e futi letrën prapë në gji dhe doli jashtë.

Pesë-gjashtë shkallët e gurta te hyrja e shko llës i zbriti me shkathësi dhe shkoi hyri, si e têr hequr vetvetiu, në mes të një grupei ku gratë këndonin me një melodi prekëse e mallëngjenjëse:

*Të më dish, moj nëno,  
Sa jam trubulluar!  
Dasma më gjzon, moj,  
Ndarja m'ka malluar!*

Ajo menjëherë vuri dorën në anën e majtë të gjirit ku fshihte letrën. Nga fjalët, e ca më tepër nga melodia e këngës, si të këndohej për të ajo këngë, iu rrëqeth zemra e lumtur dhe mbeti për

një sekondë e hutuar e me fyttyrë të zbehtë si vajzat kur nusërojnë gjithë hir e bukuri.

Shtërngoi edhe një herë fort letrën që fshihte në gji dhe mendoi me naivitet: «Mos këndojnë me të vërtetë për mua!»

Refreni prekës e mallëngjenjës vazhdonte gjithnjë pas çdo dy vargjeve:

*Të më dish, moj nëne,  
Sa jam e malluar!*

32296  
 BIBLIOTEKA E SHTETIT  
 QJYLLER

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Mantua .....	3
Ankim te nënprefekti .....	15
Hasani i derrave .....	22
Lëndohet një plagë e vjetër .....	38
Zë në furtunë .....	53
Kur mbushet kupa .....	61
Kosheret e bletëve .....	69
«Këtë mos e harro bir!» .....	75
Në ditë të vështira .....	91
Mësuesia .....	97